



Oda e Infermierëve, Mamive dhe  
Profesionistëve tjerë Shëndetësor

# Shëndeti dhe Kujdesi Infermieror

Nr. 2 / Qershor, 2024

**Gona e lirisë – Heroina e Kosovës  
që e vrau vdekjen e saj për lirinë  
tonë!**

fq. 11




**Kongresi që mbledhi mbi  
dhjetë mijë profesionistë  
shëndetësorë vendorë  
dhe ndërkombëtarë**



Kongresi i II-të  
Ndërkombëtar i OIK

05-06  
PRILL 2024



do të kaloj gjithë jetën time në  
përkrahje morale dhe të ushtrij  
profesionin tim me besnikëri.

Unë do të heq dorë nga çfarëdo  
gjëje që është shkatërrimtare dhe  
dashakeqe, si dhe nuk do të mbaj  
dhe nuk do të jap kurë me igrorinë  
time asnjë pacient me dëmtim.

Zotohem se Unë do të bëj gjithçka  
kamë mundësi për të rritur nivelin  
tim profesional dhe do të mbajë në  
fshetësi gjithçka personale apo  
familjare që më është besuar nga  
gjatë ushtrimit të detyrës, ku jam  
thirrur të shërbej.

Do të bashkëpunoj me besnikëri me  
Mjekun dhe do të përkushtohem me  
devotshmëri mirëqenies së atyre  
pacientëve që kanë nevojë për  
përkujdesjet e mia.

to lead a worthy life and to  
exercise my profession  
honourably.

I shall abstain from anything  
that is harmful or injurious, and I  
shall not take or give any  
substance or product that is  
harmful to health.

I will do everything in my power  
to raise the standard of nursing  
and will treat as confidential all  
information disclosed to me in  
the exercise of my profession, as  
well as all family matters in my  
patients.

I will be a faithful  
doctor to the well  
entrusted



**Puna me nderë është avokati  
më i mirë i infermierëve**

fq. 4



**Dugolli: Duke fuqizuar  
komunitetin tonë, përmirëso-  
jmë shëndetin dhe kujdesin për  
pacientët**

fq. 6





Oda e Infermierëve, Mamive dhe  
Profesionistëve tjerë Shëndetësor

## Oda e Infermierëve, Mamive dhe profesionistëve të tjerë shëndetësor - OIK

Kryetare - Nexhmije Gori

www.oik-ks.org  
revistaoik@gmail.com  
Rr. "Holger Pedersen",  
Prishtinë 10000, Kosovë

### Kryeredaktor

Muharrem Arifi

### Zv. Kryeredaktorë

Lirije Beqiri

Donika Shahini Lami

### Anëtarë të redaksisë

Xhavit Ramadani

Rexhep Jakaj

Feim Hasani

Vlora Ejupi

### Lektor

Xhavit Ramadani

### Distribuími online dhe radhitje kompjuterike

Besian Hajrizi

### Shtypi:

Tirazhi: 3000 copë

### Revista jepet falas!

Referencat vendosen  
vetëm në versionin  
online

Prishtinë, Qershor 2024

## Editorial

# Kongresi na fuqizoi në arenën ndërkombëtare



**Nexhmije Gori**

ka treguar edhe një herë se ne si shoqëri ia dalim në organizime të këtij niveli. Ky kongres kishte për qëllim që të forcojë rolin dhe bashkëpunimin ndërmjet profesionistëve të kujdesit shëndetësor, duke ndikuar direkt në ofrimin e shërbimeve, promovimit dhe përmirësimit të shëndetit të popullatës në përgjithësi.

Ky qëllim është arritur në plotni. Andaj, më shumë se kurrë, jo vetëm si obligim ligjor, por edhe si nevojë për të përcjellë zhvillimin dhe trendet e fundit që na mundëson shkencën dhe teknologjinë. Qëllimi ynë ka qenë që përmes punës cilësore të fokusohemi në një ndërhapat kryesorë në përmirësimin e cilësisë në zhvillimin e komunitetit.

Edukimi i vazhdueshëm është një ndër parakushtet që pasohet me përmirësimin dhe ngritjen profesionale por edhe të pozitës së infermiereve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësorë nga një shkallë e vlerësimit jo të mjaftueshëm në atë të barazisë dhe trajtimit meritot të komunitetit më të madh shëndetësor në vend.

Ne nuk do të mjaftohemi dhe vetkënaqemi me këto aktivitete. Do të llobojmë pandërprerë në të gjitha instancat, që secili infermier që gjen veten në profesionin e shenjtë, të ndjekë hapat që do ta çojnë në rrugë të sigurtë dhe të paraqes lirshëm pikëpamjet por edhe rezultatet e punës shkencore.

OIK ka bërë hapa të mëdhenj drejt anëtarësimit në organizata ndërkombëtare. Shkencën dhe punën shkencore është çelësi më i sigurt i këtyre dyerve, që për ne dikur ishin "të hekurta".

Ne kemi arritur përmes angazhimeve, seriozitetit në punë dhe këmbënguljes që Kosovën ta fusim në agjendën e diskutimeve për anëtarësime.

Besoj fuqishëm se mandati ynë do të jetë mandat i anëtarësimit në organizatat ndërkombëtare infermiore, duke barazuar për nga kompetenca, përgjegjësia dhe për nga rëndësia, secilin infermier kosovar me ata të vendeve të rajonit, Evropës e pse jo edhe botës.

Transparenca dhe llogaridhënia do të jenë një tjetër anë e medaljes gjatë udhëheqjes time dhe besoj fuqishëm se vetëm në këtë mënyrë do t'i japim vulë përpjekjeve dhe qëndrimeve tona.

Për fund, një falënderim i posaçëm për këtë pasqyrim dinjitos që po i bëhet Kongresit dhe e falënderoj gjithsecilin profesionist shëndetësor që nuk po ndalon së punuari që OIK të jetë meritueshëm aty ku e ka vendin.

Falënderime të shumëta nga udhëheqës të institucioneve vendore dhe ndërkombëtare po vijnë çdo ditë në adresën e Odës së Infermierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësorë. Këto lidhen me dy data të këtij viti.

Më 05 dhe 06 Prill 2024 shtëpia jonë, OIK ka hapur dyert në mënyrën më të përzemërt për pjesëmarrësit e Kongresit të II-të Ndërkombëtar të profesionistëve të kujdesit shëndetësorë. Ky Kongres i organizuar nga Oda e Infermierëve, Mamive dhe Profesionistëve tjerë shëndetësor me moton:

*"Roli, rëndësia dhe sfidat në avancimin e praktikave profesionale të profesionistëve shëndetësorë"*



# Legjislatura e parë e OIK-ut (23 janar 2015 - 22 janar 2019)

**Muharrem Arifi**  
**Prishtinë, Qershor 2024**

Oda e Infermierëve, Mamive dhe Profesionistëve tjerë shëndetësorë të Kosovës u themelua nga

Kuvendi i Republikës së Kosovës në maj të vitit 2013 me miratimin e Ligjit për Odat e

Profesionistëve Shëndetësorë Nr-04/L-150, si pjesë e pakos legjislative reformuese brenda

Ministrisë së Shëndetësisë.

Ideator dhe përgjegjës për hartimin e ligjit për Odat e Profesionistëve shëndetësor ishte Prof.Hysni Bajrami, falë kontributit të të cilit në Kosovë për herë të parë u krijuan odat, si organizata të pavarura profesionale që ushtrjnë veprimtari publike, ku profesionistët shëndetësorë, përmes tyre do të përfaqësojnë interesat e tyre profesionale.

Zgjedhjet për legjislaturën e parë u organizuan dhe u udhëheqën nën administrimin e Komisionit

Qëndror Zgjedhor (KQZ) të formuar nga Ministria e Shëndetësisë në përberje: Prof. Hysni Bajrami, Dr. Astrit Kuqi, Dr. Ramadan Halimi, z.Bekim Murati, z.Shefqet Mehmetkaj dhe z.Sabri Caka, në një proces zgjedhor demokratik dhe transparent, duke siguruar gjithëpërfshirje profesionale, institucionale dhe territoriale.

Kuvendi i Legjislaturës së parë 2015-2019 përbehej nga 159 delegatë të zgjedhur në njësitë zgjedhore më 13 janar 2015, në të gjitha institucionet shëndetësore publike dhe private nga e mbarë Kosova.

Kuvendi i parë konstituiv i Legjislaturës së I-rë të OIK (2015-2019), u mbajt më: 23 janar 2015,



duke vendosur kështu themelet për të drejtën e vetëorganizimit, vetërregullimit, vetëqeverisjes dhe vetëfinancimit me qëllim të avancimit, mbrojtjes dhe përfaqësimit të interesave profesionale për anëtarët e saj.

Në një garë demokratike të përbërë nga shtatë kandidatë për kryetar të OIK:

z. Naser Rrustemaj, znj. Lirije Beqiri, znj. Vjollca Jusufi, z. Fitim Havolli, z. Agron Bytyqi, z.

Shkëlzen Gërvalla dhe znj. Ardiana Behrami.

Delegatët e Kuvendit të OIK-ut më datë: 23 janar 2015 zgjedhën Kryetarin e saj të parë, z.Naser Rrustemaj.

Përveç mysafirëve vendorë, prezent në këtë ceremoni ishin edhe mysafirë nga Odat dhe Shoqatat si motra të rajonit (Shqipëri, Sloveni, Maqedoni, Poloni).

Në këtë periudhë të Legjislaturës së I-rë, (2015- 2019) OIK, në mbledhjet e Kuvendit të saj zgjodhi Organet dhe Komisionet e saj, nën monitorimin e KQZ nga Ministria e Shëndetësisë.

Më datë 26.02.2015, me propozim të Kryetarit të OIK, Kuvendi zgjodhi dy zëvendëskryetarë:

z.Muharrem Arifin dhe znj.Adelina Shehun.



Anëtarë të Këshillit Drejtues u zgjedhën: Kryetare Fekrije Hasani, Zëvendës Kryetar Ismet Jashari, anëtarë: Lirije Beqiri, Sami Thaqi, Fitore Kllokoqi dhe Sulejma Mahmutoviq-Ramadani.



Anëtarë të deleguar nga Ministria e Shëndetësisë: Xhavit Ramadani, Agron Bytyqi dhe Albulena Mehmeti.

Anëtarë të Këshillit Mbikqyrës: Kryetar Jahir Mulolli, Zëvendës Kryetare Vjollca Jusufi, anëtarë: Behrije Halilaj, Ibrahim Robelli, Kajtaz Fetahu dhe Miradije Kica. Anëtarë të deleguar nga Ministria e Shëndetësisë: Ferdane Miftari dhe Shqipe Miftari.

Përfaqësues për borde dhe komisione në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë u zgjedhën: Në

Bordin Qëndror për Regjistrim dhe Licencim të profesionistëve shëndetësorë Xhemajl Dugolli, në Bordin për Edukimin e Vazhdueshëm Mjekësorë Jalldëze Kovani-Dreshaj, në Bordin për Mbikqyrjen Etike Profesionale Besnike Kolgeci, në Bordin Qëndror për Edukim Specialistik Qefsesre Bajraktari, në Komisionin për Licencimin e Infermierëve me përgatitje të mesme shkollore Besa Haliti dhe Bajram Krasniqi si dhe në Komisionin për Licencimin e Infermierëve me përgatitje të lartë shkollore Afërdita Mustafa dhe Sadete Kallaba.

Komisioni për hartimin e Statutit të OIK: Danush Dalloshi, Brahim Berisha, Servete Rexha, Agron Nebiu, Diana Shllaku, Fahrije Gashi, Besnik Rrmoku, Agim Hajdini.

Komisioni për hartimin e Kodit të Etikës Profesionale: Sevdije Shabanaj, Liridon Marku, Drita Koçinaj, Xhafer Jonuzi, Shkëlzen Gervalla, Violeta Metushi dhe Fetije Huruglica.

Komisioni për hartimin e Rregullorës së Punës së OIK: Driton Leka, Rukije Pllana, Sevim Avdullahu, Besarta Perteshani, Fatime Gashi, Besiana Bushi dhe Vlora Aliu.







Komisioni për punimin e Llogos së OIK: Neki Murtezaja, Shqipe Miftaraj, Vlora Gjickolli Hagjaj, Sabrije Ramabaja, Blerim Morina, Fehim Hasani dhe Tamer Hero. Komisioni për hartimin e Rregullorës për praktikë private profesionale: Mimoza Sadiku, Lutfi Peci, Naime Brajshori, Artan Kadriu dhe Bajram Krasniqi.

Më datë 27.03.2015, Kuvendi zgjedhi anëtarët e organeve tjera të OIK.

Anëtarë të Këshilli Etik: Kryetar Besnik Rrmoku, anëtarë: Fetije Huruglica, Murtez Jashari, Xhafer Jonuzi dhe Idriz Sopjani.

Anëtarë të Gjyqit të Nderit: Kryetar Bekim Grabovci, anëtarë: Bekim Vehapi, Naile Nitaj dhe Agron Nebiu. Prokuror i OIK-ut Bekim Sejdiu dhe Zëvendës Prokurori Agron Suma.

Komisionin për Edukim të Vazhdueshëm Profesional: Petrit Beqiri, Dushe Rafuna, Agim Hajdini, Shpejtim Shabanaj, Meleqe Morina, Kolë Abazi, Ganimete Leka, Sevdije Bunjaku, Brahim Berisha, Tamer Hero dhe Halil Gutaj.

Më datë 12.06.2015 u zgjodhën anëtarët për Komisionin për Buxhet dhe Financa: Kryetar Feim Hasani, anëtarë: Dafina Gutaj Gashi, Besian Bushi, Izet Isufi dhe Kushtrim Sylja.

Komisioni për Solidaritet dhe ndihmë reciproke: Kryetar Sezair Ruhani, anëtarë: Drita Koqinaj, Ali Lutfiu, Sabrije Ramabaja dhe Violeta Metushi.

Më datë 30.09.2015 Kuvendi miraton statutin e OIK – ut dhe bënë zgjedhja e anëtarëve për:

Komisionin për Çështje Etike: Blerim Morina, Sevdije Shabanaj, Fitim Havolli, Bashkim Meha dhe Driton Krosa.

Komisioni për Licencim me përgaditje të mesme shkollore: Kryetare Qefsera Bajraktari, anëtarë: Besa Haliti, Bajram Krasniqi, Rexhep Tahiri dhe Vllaznim Jakupi.

Komisioni për Licencim me përgaditje të lartë shkollore Bachelor: Kryetare Sadete Kallaba, anëtarë: Mentor Hasani, Aferdita Mustafa, Besnike Kolgeci dhe Sabrije Krasniqi.

Komisioni për Edukim Specialistik: Shkelzen Gërvalla, Hidajete Krasniqi, Diana Shllaku, Luljeta Kryeziu dhe Rukije Pllana.

Komisioni për Praktikë Private: Muhamet Kadrija, Vlora Gjickolli, Hanife Hoxha, Avdyl Parduza dhe Shehip Luma

Më datë 13.05.2016, delegatët e Kuvendit miratuan: Rregullorën për Regjistrim Licencim dhe Rilicencim, Rregulloren për Edukim të Vazhdueshëm Profesional dhe Vendimin për lartësinë e të hyrave dhe taksave administrative në OIK.

Më 26 tetor 2018, Kuvendi merr vendim që zgjedhjet e ardhshme për anëtarë të Kuvendit të OIK-ut të mbahen me 10 janar 2019 respektivisht për Legjislaturën e dytë 2019-2023 kur miratohet vendimi për formimin e KQZ-së dhe Miratohet Rregullorja për procedurat e

kandidimit, zgjedhjes dhe revokimit të anëtarëve të OIK-ut. Këto zgjedhje tanimë do të menaxhohen dhe udhëhiqen nga OIK respektivisht KQZ, i formuar nga Kuvendi i OIK.

### Të arriturat kryesore në OIK gjatë Legjislaturës së I-rë

Përberja e parë e Kuvendit ishte e fokusuar në ngritjen e kapaciteteve rregullative, infrastruktururore dhe teknike të OIK-ut. Mandati i parë ishte mandat i shumë sfidave, e gjithë puna ishte vullnetare, mirëpo vlen të theksohet se ky mandat ishte edhe mandat i sukseseve të medha, pasi nga Ministria e Shëndetësisë me datë 30.06.2016 filloi bartja e kompetencave në OIK, proces ky i cili vazhdoi deri në bartjen e plotë të tyre më 18 Janar 2018.

OIK organizoi punëtori nga 2-4 Mars 2016 për hartimin e draft Rregullorës për Edukim të Vazhdueshëm Profesional, draft Rregullores për punën e Këshillit Drejtues, draft Rregullorës për punën e Këshillit Mbikqyrës dhe Draftin e rregullorës rreth specifikave administrative për rilicencim si dhe mënyrës së përcaktimit të taksave administrative.

Ministria e Shëndetësisë me datë 30.06.2016 barti kompetencat në lëminë e Edukimit të Vazhdueshëm Profesional dhe Etikës Profesionale Mjekësore, e cila hyri në fuqi nga data 01.07.2016.



Po ashtu me këtë datë Ministria e Shëndetësisë mori vendim që përmes Departamentit për Buxhet dhe Financa të MSH, të gjitha taksat për licencim, rilicencim, lëshimin e certifikatave, vërtetimeve dhe dokumenteve tjera, të alokohen në xhirollogarinë e OIK-ut, e cila hyri në fuqi nga data 01.07.2016.

Ministria e Shëndetësisë më datë 03 maj 2017 bënë bartjen e kompetencave për ri-licencim të OIK. Kjo procedurë do të fillonte pas valorizimit të EVP në pajtim me aktet në fuqi dhe duke asistuar me stafin e saj administrativ. Pas këtij vendimi nga Ministria e Shëndetësisë, OIK më datë 09.06.2017 themelon Komisionin për valorizimin e dokumenteve për ri-licencimin e anëtarëve të saj, duke filluar nga data 12.06.2017. Komisioni fillon punën në këtë përbërje: Xhemajl Dugolli, Muharrem Arifi, Petrit Beqiri, Dushe Rafua, Sevdije Krasniqi,



Shpejtim Rramanaj, Kolë Abazi, Shyqri Hasani, Lutfi Peci, Raze Maksutaj, Mentor Bytyqi, Ganimete Leka, Dafina Bahtiri.

Procesi u mbështet nga MSH e cila kishte themeluar Komisionin për valorizimin e dokumenteve për ri-licencimin e Infermierëve, maimive dhe profesionistëve tjerë shëndetësorë me datë 19.04.2017 në përbërje të anëtarëve: Fetije Huruglica, Dr. Ilir Begolli, Remzi Berisha, Xhemajl Dugolli, Nyrten Zhuri, Fahrije Merovci, Igballe Buzuku, Perihane Berisha, Burbuqe Mataj dhe Lirika Beshiri.

Procesi i rilicencimit u zhvillua në tri faza. Në fazën e parë u bë valorizimi i pikëve kredituese për anëtarët që posedonin certifikata të trajnimeve. Në fazën e dytë u mbajtën trajnime të ngjeshura për të gjitha profilet dhe faza e tretë përmes provimit profesional për rilicencim të organizuar nga OIK.

Më datë 03 korrik 2017 Ministria e Shëndetësisë barti përgjegjësitë për Akreditimin e programeve të Edukimit të Vazhdueshëm Profesional të OIK.

Bazuar në ligjin për Odat me datë 01.02.2018, OIK merr vendim për fillimin e pagesës së anëtarësisë për anëtarët e saj, e cila ka hyrë në fuqi nga 1 tetori 2017.

Në kuadër të kompetencave për EVP, OIK më 10 mars 2018 organizon trajnime për komunitetin e saj, të punësuar në institucionet shëndetësore private dhe ata të pa punë.

U nënshkruan disa memorandume të bashkëpunimeve me Institucione qeveritare dhe joqeveritare brenda dhe jashtë vendit.

Pas një pune intenzive, OIK përmbyll me shumë sukses procesin e valorizimit të dokumenteve dhe dëshmive tjera të EVP për anëtarët e saj si kusht i domodoshëm për Ri-licencim të caktuar si faza e parë e rilicencimit.

Me vendim të Këshillit Drejtues të OIK u formua komisioni për projektin e domosdoshëm në krijimin e web faqes dhe Platformës Digjitale të OIK-ut, në përbërje: Fikrije Hasani, Muharrem Arifi, Ismet Jashari, Visar Kastriati dhe Xhemajl Dugolli, ku më datë 26 tetor 2018 u bë lansimi i web faqes zyrtare të OIK-ut.



Me këtë mundësi digjitalizimi i të gjitha aktiviteteve të OIK-ut në drejtim të lehtësimit të proceduarve administrative dhe aktiviteteve tjera.

OIK po ashtu bëri barasvlerësimin e programeve të profileve profesionale Asistent infermier, Ndihmës infermier, Mami, Pediatri me profilet bazike infermiore.

**Sfidat**

Sfidat ishin të mëdha, sidomos në krijimin e kushteve elementare të punës (hapësirave për punë, sigurimin për punë të stafit administrativ, pajisjeve dhe mjeteve të punës) dhe infrastrukturës ligjore si bazë për përmbushjen e kompetencave të OIK.



Bartja e kompetencave dhe përgjegjësi nga MSH në OIK rezultoi me sfida në përgatitjen e mekanizmave që do të merrnin përgjegjësinë e zbatimit të tyre siç ishte: Licencimi, Ri-licencimi dhe Edukimin e Vazhdueshëm Profesional.

Detyrat e parashtruara për përmbushjen e këtij obligimi imponuan një dinamikë dhe angazhim të shtuar të të gjitha organeve dhe stafit të OIK-ut, ku falë angazhimit të tyre kjo objektivë është realizuar me shumë sukses.

Paralel me këtë OIK i është qasur zgjidhjes së problemit shumë akut - licencimit të anëterëve që kanë ushtruar veprimtari në profilet specifike jashtë profilet bazë të licencuar duke përcaktuar kushtet dhe kriteret për zgjidhjen e këtij problemi të kahershëm.

**Bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar**



Vizitë pune në Odën e Infermierëve të Kroacisë (Zagreb 4-6 maj 2015), në Urdhërin e Infermierisë së Shqipërisë (Tiranë 25-26 qershor 2015 nënshkrimi i marrëveshjeve bashkëpunimi), vizitë pune në Odën e Infermierëve të Polonisë (Varshavë 11-14 tetor 2015). Pastaj bashkëpunim me Asociacionin e Infermierëve të Sllovenisë, me Fakultetin e Shkencave Mjekësore "Luigj Gurakuqi" Shkodër, vizitë studimore në Shqipëri dhe Slloveni, pritja e delegacioneve nga Oda e infermierëve të Hungaris, Sllovenis, Shqipëris dhe Zvicrës, si dhe



takime me përfaqësues të shoqatave vendore dhe ndërkombëtare. Pjesëmarrja në Kongresin e V-të Rajonal të Infermiereve të Kroacisë në Opati dhe takimi me znj. Judith Shamian presidente e ICN. Pjesëmarrja në Kongresin e Parë të Infermierëve të Shqipërisë të organizuar nga Urdhri i Infermierit të Shqipërisë nga 10-11 Maj 2018 në Tiranë.







**Intervistë me z. Xhemajl Dugolli, nënkryetar i OIK dhe sekretar i Kongresit të II-të Ndërkombëtar të OIK**

## **Dugolli: Duke fuqizuar komunitetin tonë, përmirësojmë shëndetin dhe kujdesin për pacientët**

*Oda e infirmierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësorë në fillim të muajit prill organizoi Kongresin e II-të me prezencë ndërkombëtare. Revista "Shëndeti dhe Kujdesi Infirmieror", ka realizuar intervistë me sekretarin e Kongresit i cili ka folur ekskluzivisht për organizimin, sfidat dhe sukseset e Kongresit i cili tashmë ka marrë karakter tradicional*

### **Prishtinë, Qershor 2024**

Kongresi i Dytë Ndërkombëtar i OIK që tashmë ka marrë karakter tradicional ishte planifikuar që nga fillimi i vitit 2023 dhe ishte pjesë e planit të aktiviteteve në kalendarin e Odës si një ndër ngjarjet më të rëndësishme të këtij viti. Kjo, duke marrë parasysh synimet e OIK për anëtarësim në organizata ndërkombëtare, sekretari i Kongresit, z. Xhemajl Dugolli thotë se ky aktivitet ndërkombëtar ishte një mundësi e jashtëzakonshme për të sjellë profesionistë nga vendet tjera dhe për të ndarë përvojat dhe për të promovuar punën dhe të arriturat e OIK-ut.

#### **Revista Shëndeti dhe Kujdesi Infirmieror:**

Z. Dugolli, cilat ishin filltet e organizimit të Kongresit të Dytë Ndërkombëtar të OIK dhe si ka shkuar mbarëvajtja e Kongresit të Dytë Ndërkombëtar të Organizuar nga OIK?

Z. Dugolli: Gjithçka filloi me planifikimin e Kongresit, u caktua një grup punues dhe pastaj edhe Këshilli organizativ nga Këshilli Drejtues i OIK-ut, u përcaktuan qëllimet dhe pastaj u vendos për datën dhe temën e Kongresit. Temë bosht e Kongresit siç tashmë dihet ishte "Roli, rëndësia dhe sfidat në avancimin e praktikave profesionale të profesionistëve shëndetësor". Ndërkohë caktuam edhe lokacionin e mbajtjes së Kongresit dhe pika më e rëndësishme ishte ajo e caktimit të kriterëve të punimeve si dhe vlersësimi i përmbushjes së kërkesave për realizimin e këtij aktiviteti.

Duke marrë parasysh vlersësimet që kemi marrë nga pjesëmarrësit ndërkombëtar, e po ashtu edhe nga ata vendorë, konsideroj se i gjithë realizimi i kongresit ka shkuar sipas planit të paraparë dhe për realizimin e këtij aktiviteti merita kanë i gjithë Këshilli Organizativ i Kongresit, Grupet Punuese, stafi i OIK, organet e OIK-ut, e në veçanti anëtarët tanë të cilët me pjesëmarrjen e tyre demonstruan një kulturë të lartë dhe i dhanë rëndësi aktivitetit tonë të përbashkët.

**Revista Shëndeti dhe Kujdesi Infirmieror:** Cilat ishin pikat e forta të Kongresit?

Z. Dugolli: Konsideroj se sjellja e mbi 130 punimeve nga profesionistët e vendeve si Amerika, vendet e BE-së, Turqia dhe vendet tjera të rajonit, ishte pika më e fortë e këtij Kongresi.



**Revista Shëndeti dhe Kujdesi Infirmieror:** Po auto kritika Juaj për Kongresin?

Z. Dugolli: Ky është veçse Kongresi i dytë ndërkombëtar dhe i pari me prezencë fizike, pasi që Kongresi i parë ka qenë online për shkak të pandemisë. Mirëpo mund t'iu them se ne kemi identifikuar pikat e forta dhe ato të dobëta dhe do të punojmë shumë për të përmirësuar dhe avancuar organizimet e tilla në të ardhmen.

**Revista Shëndeti dhe Kujdesi Infirmieror:** Nga ishin mysafirët e Kongresit?

Z. Dugolli: Me prezencën e tyre na kanë nderuar mysafirët nga Amerika, Anglia, Zvicra, Finlanda, Italia, Turqia, Shqipëria, Maqedonia e veriut dhe nga Lugina e Preshevës.

**Revista Shëndeti dhe Kujdesi Infirmieror:** Si e vlerësoni shkëmbimin e përvojave si rezultat i organizimit të Kongresit?

Z. Dugolli: Shkëmbimi i përvojave nëpërmjet kongresit është një mundësi e çmuar, kongreset e tilla na ndihmojnë shumë për të mësuar nga njëri-tjetri, po ashtu për të krijuar rrjete të reja të bashkëpunimit, ndihmojnë shumë në shkëmbimin e përvojave dhe nxisin ngritjen profesionale dhe kontribuojnë në avancimin profesional.

**Revista Shëndeti dhe Kujdesi Infirmieror:** Sa tema janë paraqitur për Kongres?

Z. Dugolli: Kemi pasur mbi 133 punime të cilat janë sjellur për publikim në Librin e Abstrakteve si dhe për prezantim.

**Revista Shëndeti dhe Kujdesi Infirmieror:** Sa punime janë prezantuar në Kongres?

Z. Dugolli: Duke parë që numri i punimeve ka qenë shumë i madh dhe ka qenë e pa mundur të prezantohen të gjitha punimet, duke marrë parasysh edhe hapësirat që nevojiten për organizime të tilla, ne në dispozicion kemi pasur tri salla të ndara, në tre sesione ku njëri sesion ka qenë për Infirmieri dhe mami, një sesion ka qenë për profilet diagnostike dhe një sesion për Psikologji klinike, ergoterapi dhe profilet të ngjajshme dhe gjithsej janë prezentuar 45 punime.

**Revista Shëndeti dhe Kujdesi Infirmieror:** Sa punime janë publikuar në librin e abstrakteve?

Z. Dugolli: Nga Këshilli Shkencor janë vlerësuar se 130 punime mund të publikohen në librin e abstrakteve, 83 punime ishin nga Kosova ndërsa 47 punime ishin jashtë Republikës së Kosovës.

**Revista Shëndeti dhe Kujdesi Infirmieror:** Sa pjesëmarrës kanë ndjekur ligjëratat në Kongres?

Z. Dugolli: OIK ka ndërmarrë të gjitha masat që këtë Kongres ta ndjekin sa më shumë profesionistë shëndetësor e në veçanti anëtarët e saj dhe ka siguruar 800 vende për pjesëmarrje me prezencë dhe po ashtu ka angazhuar një kompani duke siguruar që përmes platformës online zoom, t'iu mundësoj ndjekjen e punimeve dhjetë mijë anëtarëve të saj.

**Revista Shëndeti dhe Kujdesi Infirmieror:**

Përveç përfitimeve në Edukimin e Vazhdueshëm Profesional, a do të ketë edhe përfitime në pikë për infirmieët?

Z. Dugolli: Në këtë kongres janë trajtuar tema mjaft të rëndësishme në të tri sesionet. Të gjithë pjesëmarrësit në kongres përfitojnë 15 pikë, të cilat u nevojiten në procesin e rilicencimit. I gjithë kongresi ka qenë pa pagesë për anëtarët e OIK-ut.

Vlen të theksohet se për realizimin e Kongresit kemi pasur mbështetjen nga IHS AQH dhe EBF, po ashtu kemi pasur edhe donatorë vendor si: Prisig, Biohit, Santefarm, Shoqata e Ergoterapeuteve, Dr. Flamur Marku, Kolegji Universum, Hayat Hospital me seli në Turqi, Kolegji AAB, Fati im dhe Pribank.

**Revista Shëndeti dhe Kujdesi Infirmieror:** Cili është mesazhi më i fortë i përcjellë përmes këtij Kongresi?

Z. Dugolli: Mesazhi im por edhe i Kongresit ishte që të punojmë së bashku në ngritjen e njohurive të reja, me ide inovative, duke fuqizuar komunitetin tonë në të gjitha institucionet e sistemit shëndetësor me qëllimin e vetëm, për të përmirësuar shëndetin dhe kujdesin për pacientët.

Së bashku, mund të ndërtojmë një të ardhme më të ndritur për profesionin tonë dhe për ata që shërbejnë andaj si komunitet të angazhohemi fort në fushën e hulumtimeve shkencore, siç patëm rastin të ndajmë përvojat në këtë Kongres.





## Kongresi që mbledhi mbi dhjetë mijë profesionistë shëndetësorë vendorë dhe ndërkombëtarë

*Infermierët, mamitë dhe profesionistët tjerë shëndetësorë në Kosovë gjatë 05 dhe 06 Prillit të këtij viti kanë pasur rastin të ndjekin rezultatet e hulumtimeve të thella shkencore, të formatit vendor dhe ndërkombëtar, të prezantuar për herë të parë në Kongresin e Dytë Ndërkombëtar të OIK- ut*

### **Donika Shahini Lami**

Dyzet e pesë punime shkencore nga 127 sa janë publikuar në Librin e Abstrakteve, janë prezantuar në Kongresin e Dytë Infermior të Organizuar nga Oda e Infermierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësorë. Avancimi i praktikave profesionale të profesionistëve shëndetësorë ishte objektivë kryesore e Kongresit të i dytë ndërkombëtar me titull "Roli, rëndësia dhe sfidat në avancimin e praktikave profesionale të profesionistëve shëndetësorë", i organizuar në Prishtinë më: 05 dhe 06 prill 2024 nga Oda e Infermierëve të Kosovës.

Ky Kongres, mbledhi profesionistë shëndetësorë nga rajoni dhe e gjithë bota me pjesëmarrje të mbi dhjetë mijë infermierëve, mamive dhe profesionistëve të tjerë të kujdesit shëndetësor, si me prezencë fizike ashtu edhe online.

Nexhmije Gori, kryetare e Odës së infermierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësorë ka hapur punimet e

Kongresit, ajo në fjalën hyrëse potencoi:

"Shteti ynë, më i riu në Evropë ka punuar shumë në procesin e formimit të Odave të Profesionistëve Shëndetësorë, si organizata të pavarura dhe pavarësisht sfidave, pavarësia profesionale dhe aktiviteti rregullativ ka bërë që të gjitha problemet që kanë preokupuar komunitetin infermior me vite, të adresohen dhe të gjejnë zgjidhje ligjore, të pranueshme dhe të balancuar, në interes të profesionistëve shëndetësorë, me standarde, cilësi dhe gjithmonë duke pasur në qendër të vëmendjes pacientin", ka thënë numri një i Odës së Infermierëve.

OIK sipas kryetares Gori do të fokusohet në përmirësimin e cilësisë që është parakusht për zhvillimin e komunitetit, duke u bazuar në obligimet ligjore por edhe për të përcjellë zhvillimin dhe trendet e fundit që mundëson shkenca dhe teknologjia.

Prezenca e ekspertëve eminent të fusheve të ndryshme, ishte garancë e këtij kongresi, në arritje të standardeve më të larta evropiane në avancimin e praktikave profesionale.

Dr. Elvana Podvorica, studiuese dhe udhëheqëse e Departamentit të Infermierisë në Universitetin e Prishtinës, ka prezantuar para infermierëve hulumtimin shkencor me titull: "Vlerësimi i perceptimit të njohurive për higjienën e duarve tek infermierët në katër klinika të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës".

Temë tjetër shumë e rëndësishme si për nga të gjeturat ashtu edhe rëndësia ishte hulumtimi i prezantuar nga znj. Blerina Duka, kryetare e urdhërit të infermierëve të Shqipërisë.

Po ashtu, në kongres mes shumë punimeve me mjaft interes ishte edhe hulumtimi për përdorimin dhe rezistencën e antibiotikëve, një studim i ndërgjeg-





jësimit të publikut në shumë vende të kujdesit shëndetësor parësor në Kosovë, prezantuar nga studiuesja Adelina Ismaili.

Ky hulumtim, sjell informata të rëndësishme lidhur me perceptimin dhe njohuritë e popullatës në përdorimin e drejtë të antibiotikëve dhe rezistencën anti-mikrobike. Rezultatet nga ky hulumtim theksojnë rëndësinë e drejtë të popullatës dhe formulimin e strategjive shëndetësore për të promovuar përdorimin e përgjegjshëm të antibiotikëve.

Analiza e ndikimit të faktorëve të motivacionit në kënaqësinë në punë të infermierëve në Klinikën e Pediatriisë në QKUK u prezantua nga studiuesja Vlora Sopi. “Në kënaqësinë e përgjithshme të infermierëve me punën, ndikimi i faktorëve të brendshëm të motivimit personal të kënaqësisë është treguar më i madh se i atyre të jashtëm, e që ishin të lidhur me kushtet e punës”, ky ka qenë rezultati përfundimtar i këtij hulumtimi.

Drejtori i Spitalit Hayat, Dr. Fatih Özku, i cili ishte i pranishëm në këtë Kongres, theksoi se këto dy ditë për të ishin shumë të veçanta. Ishin ditë kur përmes një kongresi “pasqyrohet misioni të cilin e ushtrojmë, besimi i cili na është dhënë si dhe detyra dhe përgjegjësia që na takon”. Gjithashtu ai bëri thirrje që infermierët të jenë gjithmonë bashkë të përkushtuar që të bashkëpunojnë dhe të ndajnë ide dhe projekte të reja, ngase vetëm së bashku Infermierët dhe profesionistët tjerë shëndetësorë do t’i shërbejnë Kosovës për të përmirësuar sektorin shëndetësor, pasi që Kosova është në rrugë të mbarë që të jetë një qendër e fortë e njohurisë dhe bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e

shkencave shëndetësore” – ka thënë ndër të tjera Dr. Fatih Özku.

Në këtë kongres sesion të veçantë kishte edhe për psikologët klinikë, logopedët dhe ergoterapistët. Punime dhe hulumtime cilësore të cilat prezantojnë realitetin e shëndetit mendor në Kosovë, duke treguar edhe sfidat dhe përvojat e klientëve.

Dr. Fitim Uka - Psikolog klinik, ka prezantuar



hulumtimin “Ndryshimet e shëndetit mendor pas terapisë së kohezionit të brendshëm”. Teoria dhe psikoterapia e kohezionit të brendshëm është një gërshe-tim i hollë mes dilemave dhe supozimeve ekzistenciale që autori i trajtoi në hulumtimin e tij. Hulumtimi kohezionin e brendshëm e sheh si formë më të integruar dhe mënyrën më adekuate të ndërhyrjeve me njohuri, qasje dhe preventivë të re.

Eksplorimi i marrëdhënieve të stilit kognitiv me vetëvlerësimin, cilësinë e jetës dhe përballimin tek të rinjtë në Kosovë, ishte tema hulumtuese e prezantuar nga Dr. Sevim Mustafa. Ky hulumtim trajton marrëdhëniet e pa eksploruara ndërmjet stileve njohëse dhe faktorëve psiko-social. Studimi anketoi 490 studentë të moshës 15-23 vjeç. Hulumtimi sugjeroi që indi-

vidët me prirje më të lartë të të menduarit analitik kanë më shumë gjasa të jenë meshkuj dhe të përdorin strategji të përballimit të fokusuara tek emocionet.

Ergoterapia formalisht po zhvillohet në Kosovë që nga viti 2012. Dr. Diana Ullrich ka folur për rëndësinë e ergoterapisë që sipas saj, ndjek një rrugë specifike trajtimi, me klientin në qendër. Prezentimi i saj ishte mjaftë profesional dhe me shumë rëndësi për komunitetin.

Ndërkaq, psikologu klinik Visar Sadiku ka prezantuar punimin: “ADHD, prevalenca, trajtimi dhe rezultati terapeutik”. Të gjeturat e këtij punimi flasin për tipet dhe nëntipet e këtij çrregullimi neurologjik, për efektin që ka në të gjitha moshat dhe për mënyrat e duhura për t’i menaxhuar simptomat. Psikologu Sadiku, ka folur për dallimet që ka ky çrregullim tek fëmijët dhe të rriturit, duke ofruar rezultate si opsione rreth aktiviteteve që ndihmojnë në uljen e intensitetit të simptomave.

Pas kongresit, OIK ka marrë edhe shumë falënderime, e një nga ta është edhe ai i zonjës: Anu Soderstrom nga Këshilli i Ergoterapistëve të Evropës (COTEC).







**Intervistë me z. Bashkim Mehmeti, Kryetar i Këshillit Drejtues të Odës së Infermierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësorë**

## Puna me nder është avokati më i mirë i infermierëve

*Objektiv i KD të OIK mbetet anëtarësimi në organizatat ndërkombëtare, thotë në intervistë për Revistën Shëndeti dhe Kujdesi Infermieror: Z. Bashkim Mehmeti, kryetar i KD të OIK. Ai porositi komunitetin që të punojnë me nder e përkushtim sepse vetëm kështu mund të arrijnë synimet e tyre.*

**Muharrem Arifi**

### Prishtinë, Qershor 2024

Pozitën që mbanë, nuk e ka marrë si një privilegj, por si një detyrë për t'i shërbyer komunitetit infermieror. Bashkim Mehmeti, kryetar i KD të OIK, thotë se politikën e Odës së Infermierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësorë do të orientohen sipas kërkesave të anëtarësisë së OIK që paraqet komunitetin më të madh shëndetësor në Kosovë.

**Revista Shëndeti dhe Kujdesi Infermieror:** Z. Mehmeti, ka rreth 15 muaj që jeni vënë në krye të Këshillit Drejtues të Odës së Infermierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësorë. Cilat janë sfidat dhe sukseset kryesore të KD të OIK gjatë këtyre muajve?

**Mehmeti:** Sfidat sikurse edhe sukseset janë të shumta. Përcjellja e punës së komisioneve dhe evitimi i grumbujve të lëndëve për shqyrtim është e arritura më e madhe ngase infermierët, mamitë apo edhe profesionistët tjerë shëndetësorë tani nuk presin më gjatë se sa konform rregulloreve të OIK.

Gjatë vitit 2023 organizimi i sesioneve për infermierë, mami dhe profesionistë tjerë shëndetësor në kuadër të EVP në të gjitha qendrat e Kosovës ka qenë një aktivitet që është përshëndetur nga të gjithë profesionistët shëndetësorë, si ata që punojnë në sistemin publik shëndetësor po ashtu edhe ata të sistemit privat apo të papunët.

Mbajtja e Kongresit Ndërkombëtar këtë vit, më 6 dhe 7 maj, po ashtu ka qenë diçka që është përshëndetur me shumë përkushtim si nga pjesëmarrësit në konferencë e gjithashtu edhe nga pjesëmarrësit që janë kyçur në formën online. Pra, kishim një Kongres mjaft të suksesshëm me pjesëmarrës të shumtë nga vende të ndryshme të botës.

**Revista Shëndeti dhe Kujdesi Infermieror:** Si do të adresoni sfidat aktuale në menaxhimin e punës së Odës së Infermierëve?

**Mehmeti:** Sfidë kryesore për komunitetin infermieror mbetet legjislacioni. Ne edhe sot nuk kemi një ligj për infermierët që do të ndihmonte shumë në qartësimin e pozicionit të infermierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësorë. Kjo, duke filluar nga përgjegjësitë e tyre dhe të drejtat në punë. Po ashtu, ky ligj do të definonte edhe aspektet tjera që lidhen me kontributin, nivelin e shkollimit dhe pagesat kundrejt kualifikimeve. Andaj, konform përgjegjësisë që ka, Këshilli Drejtues i OIK do të adresojë secilën nga këto çështje dhe do të jetë një shtytës i fuqishëm në realizimin e interesave të anëtarëve të OIK.

**Revista Shëndeti dhe Kujdesi Infermieror:** Cilat janë vendimet më të rëndësishme që janë marrë në mandatin tuaj?

**Mehmeti:** Së bashku me anëtarët e Këshillit Drejtues të OIK, gjithmonë duke u mbështetur në Ligjin për Odat e Profesionistëve Shëndetësorë dhe Statutin e OIK, e në kuadër të përgjegjësisë që kemi gjatë kësaj periudhe kohore kemi nxjerrur një numër të konsiderueshëm të vendimeve. Ia vlen të përmendim Vendimi nr. 506 i datës: 07 prill 2023 që ka të bëjë me rregulloren për shërbimin profesional të OIK, si dhe një sërë vendimesh që lidhen me punën profesionale të OIK, edukimin e vazhdueshëm, këshilldhënien, caktimin e kordinatorëve regjional të OIK. Po ashtu vendimi për caktimin e komisionit të revistës "Shëndeti dhe Kujdesi Infermieror", e të cilat vendime janë marrë me vota unanime dhe janë të pranuar dhe të kapshme për të gjithë anëtarët e kuvendit të OIK si dhe të gjithë infermierët, mamitë dhe profesionistët tjerë shëndetësor.

**Revista Shëndeti dhe Kujdesi Infermieror:** Cila është kompaktësia e KD të OIK?

**Mehmeti:** KD i OIK është shumë kompakt dhe pa anëtarët e KD dhe administratës së OIK nuk do të ishte e mundur të funksionojë e as të flasim për suksese të OIK. Është me rëndësi që komuniteti ta kuptojë se ne asnjë vendim të rëndësishëm nuk e marrim në mënyrë vetanake dhe pa marrë mendimin e përfaqësuesve të tyre. Kjo na bën që të punojmë dhe të dalim ballëhapur para tyre.

**Revista Shëndeti dhe Kujdesi Infermieror:** Cilat janë objektivat e KD të OIK të kësaj legjislature?

**Mehmeti:** Tani për tani më duhet të them se jemi në rrugë të mbarë për anëtarësimin e OIK në EFN. Kjo është ajo që na forcon dhe na inkurajon për të ardhmen. Gjithashtu vazhdimi i qëndrimit sa më afër me infermierët dhe diskutimi me të gjithë ata mbi problemet, vështirësitë si dhe sfidat që ata i kanë është prioritet për mua si kryetar dhe të gjithë anëtarëve të KD të OIK. Gjithashtu, shtyerja përpara e proceseve dhe politikave që do të ndikonin pozitivisht në profesionin e infermierisë, do të jetë pjesë e pandashme e të gjithëve neve që jemi në KD të OIK. Kjo ka qenë moto e imja qysh kur kam marrë vendimin për t'i hyrë garës për këtë pozitë.

**Revista Shëndeti dhe Kujdesi Infermieror:** Si do të siguroni që zërat e infermierëve në komunitet do të dëgjojnë?

**Mehmeti:** Ne si OIK e as si KD nuk do të ekzistojmë pa komunitetin. Infermierët janë baza jonë andaj edhe zëri i tyre dëgjohej dhe do të dëgjohej përgjithmonë.

Unë ftoj gjithë infermierët që kanë ide, merren me shkencë dhe kanë punime tashmë të adresojnë ato edhe në revistën e Odës. Po ashtu, problemet që mund të kenë të çfarëdo lloji e që janë në kompetencën e zgjidhjes nga ana jonë, ne iu garantojmë se do të merremi me secilën sfidë të tyre. Ne jemi këtu për komunitetin dhe në shërbim të anëtarësisë. Nuk jemi për të gëzuar privilegje nga pozitë që kemi, por për t'i shërbyer komunitetit. Politikën e OIK do të orientohen sipas kërkesave të komunitetit.

**Revista Shëndeti dhe Kujdesi Infermieror:** Si do të ndikoni në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të ofruara nga OIK?

**Mehmeti:** Ne do të ofrojmë mundësi të reja edhe përmes zhvillimit teknologjik duke ofruar mbështetje për trajnimet që akrediton OIK. Pra, EVP të jetë në trend dhe konform me zhvillimet shkencore dhe ato teknologjike. Është shumë me rëndësi që procesi i EVP të jetë në vazhdimsi dhe nga konferencat, kongreset dhe seminarat që organizon komuniteti të marrim përvojat e secilit regjion, pasi puna dhe angazhimi nuk është i koncentruar vetëm në trajtimin e sëmundjeve por duhet kushtuar një rëndësi e veçantë edhe promovimit e parandalimit. Kjo do të rriste cilësinë e shërbimeve ndërkaq OIK do të mbështetë secilën kërkesë dhe iniciativë. Zyrat tona janë dhe do të jenë të hapura për secilën ide të komunitetit tonë.

**Revista Shëndeti dhe Kujdesi Infermieror:** Për fund, cila është porosia Juaj për komunitetin infermieror?

**Mehmeti:** Porosia ime për infermierët, mamitë dhe profesionistët tjerë shëndetësorë është që secili nga ata të respektojnë legjislacionin, kodin etik dhe të jenë gjithmonë në krye të detyrës, ngase kështu ata respektojnë pacientin, institucionin ku punojnë dhe vetveten.

Ne kemi dhënë shembuj të shkëlqyeshëm dhe kontribut të jashtëzakonshëm si gjatë periudhës së luftës, gjatë pandemisë me Covid-19 dhe në kushte tashmë shumë më të favorshme duhet të jemi shembull i institucionalizmit dhe devotshmërisë në punë. Jo rastësisht thuhet se ndërgjegjja e pastër është avokati më i mirë i shpirtit. Ky le të jetë një mesazh për gjithë ne që punën profesionale ta kryejmë me nder dhe ndërgjegje. Kurse, sfidat të na forcojnë dhe të mos dorëzohemi asnjëherë.





**Aktivitetet, angazhimi dhe puna e infermierëve në repartin e Emergjencës në Spitalin e Përgjithshëm të Gjilanit**

## **Përpjekjet e infermierëve gjilanas, për shpëtimin e jetëve**

*“ Tanimë trendi apo praktika na ka treguar se puna dhe aktivitetet e ndryshme të kujdesit shëndetësor nuk vlerësohen më në sasi të shërbimeve, por përkundrazi, ajo po vlerësohet në cilësinë e ofruar të atyre shërbimeve ndaj pacientëve “*

**Xhavit Ramadani**

**Gjilan, 2024**

Kujdesi shëndetësor në repartin e Emergjencës në Spitalin e Gjilanit paraqet një sistem kujdesi shumë të organizuar si dhe të dizajnuar për të ofruar kujdes të mirëfillt mjekësor emergjent. Ai u dedikohet të sëmurëve, të lënduarve, të aksidentuarve apo çfardo problemi tjetër shëndetësor emergjent që paraqitet tek pacientët. Në këtë repart detyrë e çdo infermieri është që secili pacient të sistemohet të triazhohet, të monitorohet, të kryej të gjitha ekzaminimet e nevojshme që ndërlihen me natyrën e sëmundjes pastaj të observohen ata deri në diagnostifikim duke u trajtuar, stabilizuar dhe që në fund ose sistemohen në reparte të Spitalit të Përgjithshëm të Gjilanit, ose lirohen në gjendje të mirë shëndetësore, për në shtëpi apo edhe duhet transportuar për në QKUK në Prishtinë.

Cilësia e shërbimeve shëndetësore të ofruar në repartin e Emergjencës në Spitalin e Gjilanit është e përqëndruar kryesisht në rezultatet dhe përm-bushjen e kënaqësinë e pacientëve. Tanimë trendi apo praktika na ka treguar se puna dhe aktivitetet e ndryshme të kujdesit shëndetësor nuk vlerësohen me sasi të shërbimeve, por përkundrazi, ajo po vlerësohet në kualitetin e shërbimeve kundrejt pacientëve. Ky tranzicion drejt përdrejt ndikon në ngritjen e imazhit të infermierëve, fitimit të besimit në repartet e Emergjencave si dhe përgjithësisht të kujdesit shëndetësor.

Violeta Leka – Infermiere: Puna dhe angazhimi im në repartin e Emergjencës daton qysh nga viti 2003, aty unë kam marr hapat e parë drejt ofrimit të shërbimeve shëndetësore infermiere si praktikane e pastaj edhe infermiere. Këtu puna është atraktive dhe me shumë satisfaksion, mirëpo nuk duhet anashkaluar edhe rastet e shumta kur kemi mbingarkesë dhe shumë stres. Këtë e kemi sidomos kur jemi pak punëtorë apo infermiere në ndrrim gjatë orarit të punës, ditëve të festave të ndryshme siç janë: Festa e Vitit të Ri, festat e ndryshme kombëtare e ato fetare dhe që shërbimet tjera janë të kufizuara në punë dhe që Emergjencia duhet të punoj me kapacitet të plotë dhe bile mezi që i plotëson nevojat për pacientët, ngase kemi fluks të shtuar të pacientëve të lënduar, të aksidentuar, të sëmurë apo edhe me gjendje shëndetësore të përkeqësuar.

Avdirrahim Hajrullahu – Infermier: Punën në repartin e Emergjencës këtu në S.P të Gjilanit e bëj nga viti 1999 e këndej. Jam shumë i përkushtuar dhe tejet ambicioz për këtë që mundem dhe që di ta bëj. Edhe sa i përket kushteve të punës tani kemi kushte shumë më të favorshme se në atë periudhë kohore kur e kam filluar punën, megjithatë e potencoj se këtu duhet punuar shumë më shumë si dhe duhet siguruar dhe ofruar kushte më të mira për punë, e

ato duhet të jenë si në sigurimin e resurseve humane e po ashtu edhe në infrastrukturë të repartit e në teknologji të ndryshme si dhe paisje mjekësore. Më duhet ta them gjithashtu se infermierët në këtë repart janë shumë të ngarkuar ngase këtu ofrohen shërbime dhe kujdes shëndetësorë njëzet e katër orë në ditë, shtatë ditë në javë si dhe asnjëherë nuk ka ndonjë pauzë apo kohë kur këta infermierë mund të llogarisin të jenë më të lirë, pra e pranoj se këtu kemi raste që vërtet janë dhe duhet të marrin shërbimet tona, por kemi edhe raste të tjera të cilat faren nuk janë për repartin tonë po që asnjëherë nuk mund t'i refuzojmë dhe të mos iu ofrojmë shërbimet tona shëndetësore.

Valbona Gashi – Infermiere: Përvoja ime në repartin e emergjencës këtu në S.P të Gjilanit ka filluar pak më vonë ngase fillimisht në vitin 1999 kam filluar punën në QKUK në klinikën e Emergjencës, ajo që dallon nga atje dhe këtu është që atje mbingarkesa është edhe më e madhe si dhe numri i shërbimeve



është shumë më i madh se këtu, pra aty infermierët përballen me numër më të madh të pacientëve e sidomos me raste të rënda të cilët janë nga vetë qyteti i Prishtinës me rrethinë po edhe nga rajonet ngase aty gravidojnë nga spitalet e përgjithshme, ndërsa këtu infermierët janë pak më të kursyer me numrin e pacientëve, por që sfida në vete është transporti i pacientëve në gjendje të rëndë. Kur e them këtë dua të potencoj se autoambulancat janë shumë jo komode dhe me kushte jo të favorshme për punë apo ndërhyrje infermiere gjatë udhëtimit, pastaj infrastruktura rrugore është shumë e dobët dhe transporti zgjat më shumë se sa që planifikohet, gjithashtu edhe mungesa e infermierëve dhe personelit tjetër shëndetësor ndikon ngase vetëm një infermier duhet ta shoqëroj pacientin për në QKUK, e në raste të rënda është edhe mjeku specialist.

Shukrije Miftari – Infermiere: Punën time Infermiere



në Emergjencë mundohem ta bëj me një përkushtim dhe ndjesi të madhe, aty përballëmi me shumë sfida dhe pengesa, shpesh herë jemi të lumtur kur pacienti vie në gjendje shumë të rëndë dhe brenda një kohe shumë të shkurtë ai këndellet dhe bashkohet me familjarët e tij për të vazhduar tutje, por ajo që është sfiduese dhe shumë e rëndë kur kemi humbje të jetës së pacientëve dhe që edhe përkundër shërbimeve të ofruara, masave të ndërmarra, reanimimit kardio-pulmonar të ofruar për kohë të gjatë e që të gjitha këto nuk japin efekt dhe e humbim pacientin, kjo është dhimbje e dyfishtë ngase ndiejm dhimbje për pacientin e humbur po edhe një dhimbje për faliljarët apo përcjellësit e pacientit të cilët në shumtën e rasteve janë falënderues për neve dhe punën që e bëjmë, por që nuk përjashtohen edhe rastet që ne jemi të fyer dhe të përbuzuar nga ata për atë që nuk kemi mundur më tepër të bëjmë për të shpëtuar jetën e pacientit.

Sevdije Musliu – Kryeinfermiere: Puna ime fukusohet në kordinimin e aktivitetëve të ekipeve këtu në këtë repart, e punët me ekipe i realizojmë shkëlqyeshëm dhe shumë pak kemi ankesa nga pacientët apo familjarët e tyre. Puna e stafit infermior në përgjithësi është e kënaqëshme mirëpo ata duhet kuptuar se kanë ngarkesë në punë, numër të orëve shtesë ngase brenda muajit shkaku i punës në ndrrime arrijnë numër të caktuar të orëve, si dhe kushteve të punës për të cilat unë si infermiere e repartit çdo ditë e ngrë zërin dhe mundohem që t'i siguroj ato krahas mundësive që i kemi. Gjithashtu sfida në vete është edhe mungesa e paisjeve dhe barnave e medikamenteve të caktuara që shpesh ne mbetemi pa ato dhe që si shërbim i Emergjencës duhet patjetër t'i kemi për pacientët. Më duhet të them edhe atë se ne mbrenda një viti kalendarik përafërsisht kemi 30 deri në 34 mijë pacientë që frekuentojnë këtë repart, dhe që sipas njësive të repartit të Emergjencës 18-20 mijë pacientë kërkojnë ndihmë nga lëmia e kirurgjisë, 12 deri në 14 mijë që kërkojnë shërbime për probleme internistike, e të observuar brenda vitit kemi diku një numër prej 21-23 mijë e të cilët për një kohë përcillen aty dhe që pastaj lirohen për në shtëpi, detyrohen të shtrihen në reparte të ndryshme të S.P të Gjilanit apo edhe duhet transferuar për në QKUK, si dhe një numër prej 200 – 500 raste të cilët trajtohen në njësinë e reanimimit. Pra afërsisht mbrenda njëzetekatër orëve në këtë repart marrin shërbime 80-140 pacientë që krahasuar me numrin e stafit infermior është numër shumë i madh i pacientëve dhe që krahas atyre duhet të sigurohet një numër shumë më i madh i infermierëve për të pasur një punë efektive dhe cilësore.





## Gona e lirisë – Heroina e Kosovës që e vrau vdekjen e saj për lirinë tonë!

**Donika Shahini - Lami**

Në ditët kur po i përkujtojmë heronjtë në datat e përjetësisë së tyre, deomos të bie në sy mosha kur ata u përjetësuan. Shumë nga ta ishin tek të njëzetat e disa edhe më të rinjë! Një nga ta ishte edhe heroina Antigona Fazliu - infermiere dhe ushtarë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Drenica është vendi ku zemra të rrah më shpejt se zakonshëm. Vendi ku njeriu reflekton mbi të kaluarën, të tashmën dhe të ardhmen. Vendi i dhimbjes por edhe krenarisë së madhe.

Me Nexhmije Gorin, kryetarën e OIK-ut, e kishim planifikuar ka disa muaj që të merrnim rrugë për Prekaz. Doja që Nexha nga afër të njëhej me familjen Kodra në Prekaz të Drenicës. Familjen e gjeneral Ilaz Kodrës. Familjen që për mua tash e 26 vite u bë frymëzim dhe udhërryfes jete. Doja t'i takonte nga afër dhe të dëgjonte rrefimet dhe përjetimet e tyre. Familjen që përjetësisht duhet t'iu përkulemi dhe t'ua kërkojmë bekimin si komb! Doja që Nexha ta njëhte edhe nga rrefimët e motrës dhe familjarëve heroizimin e një infermiere të re.

E një vajze të çeliktë dhe shembull. E vajzës që sakrifikoi rininë e saj për të jetuar në lirinë tonë!

Përvjetori i rënies së Gjeneral Ilaz Kodrës, Antigona Fazliut, dita e dëshmorëve dhe java e infermierisë, shumë arsye që gjithmonë t'i kthehemi Prekazit, Gradicës dhe gjithë Drenicës.

Ky vend të mbush gjitha boshllëqet dhe të jep forcë. Ky vend të shton jetë!

Në detaje po evokoja kujtime dhe po i tregoja punën time si gazetare gjatë luftës në Prekaz e gjithandej në Drenicë. Detaje dhe të vërtetën për luftën dhe krenarinë tonë. Pa e fshehur as dhimbjen e madhe. Disa herë bile edhe emocionet më tradhtonin.

Natyrshisht pas nderimit tek Jasharët, nisemi drejt kullës legjendare të familjes Kodra, sepse rrefimi që do të evoknim nuk kishte mundësi të pristë më!

Emocion e kaluar emocionit. Sa e sa kujtime. Çfarë historie. Tek shtëpia na pret Kimetja. Kimete Kodra, gruaja e Ilazit. Shoqja e tij e jetës. Heroina e gjallë.

Ma shumë se krenare që sot për të shumtën herë isha tek vendi që më mbushë frymëzim, krenari por ama edhe ma kthen dhimbjen e madhe.

Prekazasit janë trima dhe trimëresha të njëmendtë. Këtë ata e kanë dëshmuar jo vetëm në këtë luftë, jo vetëm në vitet e luftës së fundit e të rezistencës sonë kombëtare, por edhe më parë, që nga rasti i Ahmet Delisë, pastaj i Tahir Mehës e deri tek lufta e komandantëve Adem Jasharit, Hamëz Jasharit, Ilaz Kodrës dhe familjeve të tyre e shumë e shumë trimave e trimëreshave.

Të gjitha këto heroizma janë një testament i çmueshëm i kësaj toke dhe i këtij vendi të veçantë. Por, prekazësve iu bashkuan edhe shumë të rinjë e të reja në luftën e tyre të shenjtë. Iu bashkua edhe infermierja e re nga Gradica, për t'iu bashkuar luftës deri në frymen e saj të fundit!

Më 30 prill të këtij viti, u mbushën plot 25 vite nga rënia heroike për liri e Ilaz Kodrës dhe Antigona Fazliut. Dy dashuritë e Kimetës. Bashkëshorti dhe motra e saj e vogël, Gona, infermierja më e re e luftës, bie në altarin e lirisë me 30 prill të vitit 1999.

Profili i Antigonës më mallëngjen pa masë. Edhe pse e re në moshë ajo e sfidoi vehten dhe lirinë e saj për të prekur historinë, duke iu dalë në ndihmë të plagosurve dhe duke luftuar për lirinë që sot ne e gëzojmë.

Kimetja ngadal nisë rrefimet për Gonën e saj. I lidhen fjalët dhe natyrshëm ia lexoj dhimbjen... Hapë qantën e luftës së saj e cila qëndron tash e 25 vite ashtu siç e ka lënë Gona. Shikon në të. Fasha, dorëza dhe disa mjete të ndihmës së parë. "Më emocionon fort kjo qantë...." - na thotë. "Gonja këto pak mjete kishte atë ditë me vete, dhe thajse e ka pasur të pamundur nga plagët e marra të i shfrytëzonte..."

Heshtje...kurse unë edhe pse këtë rrefim e kisha dëgjuar sa e sa herë prapë mbetëm pa fjalë...

E mendoj nënën Hyrë si ka mundur dhe si ka gjetur forcë ta vazhdoj jetën.

Plotë një dekadë e sa pas saj!

Sa më shumë kalojnë vitet, kuptimësohet përjetësia e tyre. Një emruer kishin çlirimtarët. Atdhedashuri quhet!

Edhe pse e re në moshë, ajo e kishte vullnetin dhe dëshirën për t'i dalë në ndihmë





jidhej si luftëtare për ngritjen e Flamurit Kombëtar në manifestimin e organizuar për nder të flamurit kombëtar. Aty e kam parë nga larg, por nuk e kam takuar. Antigona ishte Gona e flamurit atë ditë. Ajo kontributin e saj e dha bashkë me Dr. Lec Gradicën dhe Emine Gashin - Lecin, në spitalin e UÇK-së, në Gradicë të Drenasit, atje ku burrat dhe gratë e pushkës, të cilët shtoheshin çdo ditë, kishin shumë nevojë që dikush tua mjekonte plagët e marra nga betejat e shumta.

Infermierja e re do të angazhohet në mjekimin e të plagosurve dhe në luftimet kundër armikut. Pas marrjes së komandës në brigadën 114, nga Ilaz Kodra si udhëheqës i saj, komandanti organizoi betimin solemn të ushtarëve, me ç' rast në betimin përurues, ishte edhe Antigona Fazliu, si ushtarja më e re, e cila tani e tutje do të merrte pjesë edhe në beteja të drejtpërdrejta me armikun.

popullatës që atë kohë kishtë shumë nevojë për ndihmën e parë. Emri dhe fytyra e saj hyjnore është e ruajtur në kujtimet më të mira të shumë e shumë të plagosurve të asaj kohe. Paslufta do të më mundësonte të njihja shumë njerëz që më përmëndnin emrin dhe kontributin e Gonës.

Antigona Fazliu, na vulos faktin se krahas burrave edhe shumë e shumë vajza të reja dhe gra iu bashkuan luftës dhe dhanë kontributin e tyre siç e donte koha.

Për jetën dhe veprën e saj heroike nuk do të mund t'i gjej fjalët më të mira, më të veçantat dhe më përkushtueset...por e di që deri në frymen e fundit do ta kem frymëzim. Antigona me rastin e 28 - Nëntorit të parë, të vitit 1998, pas rënies së komandantit Adem Jasharit, do të përzg-

Po atë kohë përveç dëmeve dhe shkatërrimeve tjera nga sulmet barbare të pushtuesve serbë do të digjej edhe spitali ushtarak në Gradicë, ndaj pas djegies së tij, me mësimet që kishte marrë nga shkolla dhe përvojën praktike të fituar në atë spital me ushtarët e plagosur, infermierja e re do të angazhohej në dy fronte dhe kryente njëkohësisht dy funksione me rëndësi, mjekimin e të plagosurve dhe pjesëmarrjen në luftimet kundër armikut.

Për çlirimin e vendit kjo brigadë dha mëse 167 dëshmorë, në mesin e të cilëve, nga 30 prilli i vitit 1999, edhe komandantin e brigadës, trimin Ilaz Kodra si dhe ushtaren më të re të asaj brigade, heroinën Antigona Fazliu të cilët në të njëjtën

ditë u flijuan heroikisht, duke mbrojtur trimërisht, me trupat e tyre popullsinë civile nga forcat okupatore serbe në fshatin Vërbovc të Drenasit.

Antigona si e re entuziaste edhe në beteja, arriti të tregonte përkushtimin dhe vlerën e vërtetë të një luftëtareje të vendosur që çmoi lart dijen, përvetësoi



artin e shërimit mjekësor, ndihmoi luftën dhe mbi të gjitha dëshmoi se e donte me gjithë zemër vendin e të parëve dhe lirinë e tij, për të cilat luftoi dhe ra heroikisht në fushën e nderit. Dhe mu në vitet më të rënda që kalonte populli i saj, ajo iu përgjigj me krenari detyrës, sapo shqiptarët i thirri historia për lirinë e atdheut.

Pafund krenare që kam njohur dhe njoh shumë patriot të vendit tim që e vulosën lirinë tonë me gjakun e tyre, me luftën e tyre.

Sot, mu mbush zemra me dashuri por edhe me dhimbje tek sa evokuam kujtime për një kohë kur dashuria për atdhe ishte e pa çmim. Kujtime që janë vetë jeta jonë. Kujtime që ta kthejnë dhimbjen, por ama edhe krenarinë e madhe.





## OIK mirëpret anëtarët e Grupit Punues për zbatimin e ligjit për Odat e profesionistëve shëndetësorë Prishtinë, 15 maj

Oden e Infermierëve, Mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësorë e vizitoi Grupi Punues për zbatimin e ligjit për Odat e profesionistëve shëndetësorë me kryetar Bekim Haxhiun, dhe anëtarët Fatmire Kollçaku, Shemsedin Dreshaj, Burim Meta, njëkohësisht anëtarë të Komisionit Parlamentar për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Kuvendin e Kosovës.

Kryetarja e OIK, Nexhmije Gori, ka mirëpritur anëtarët e Komisionit, ajo ndër të tjera ka thënë se për OIK ky është një nga vitet më të rëndësishme që ndërlihet me reformën që po ndodhë brenda organizatës. Gori gjithashtu ka thënë se ky vit është reformues për OIK me ç'rast po përgatitet draft statuti i ri, i cili do të miratohet pas një diskutimi publik. Statuti i ri, sipas Gorit do të avancoj demokracinë e brendshme duke krijuar mekanizma të llogaridhënies dhe përgjegjësitë të të gjitha organet e Kuvendit.



## OIK ndan mirënjohje për pensionistët Prishtinë, 10 maj



Oda e infermierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësorë ka nderuar me mirënjohje infermeirë, mami dhe profesionistë tjerë shëndetësorë të cilët janë pensionuar.

Mirënjohjet janë ndarë për kontributin që ata kanë dhënë në shërbim të pacientëve dhe edukim të brezave të profesionistëve shëndetësorë.

Kryetarja e OIK, Nexhmije Gori, në fjalën e saj para pensionistëve të profesionit infermior ka vlerësuar lartë kontributin e tyre në promovimin e vlerave shëndetësore, edukim dhe ofrim të shërbimeve shëndetësore.

## Kryetarja e OIK me bashkëpunëtorë zhvilloi takime të rëndësishme në Turqi Prishtinë, 1 maj

Kryetarja e Odës së Infermierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësorë Nexhmije Gori, së bashku me Prof. Hysni Bajramin dhe udhëheqësen e zyrës së psikologëve klinik Donika Shahini Lami, qëndruan për vizitë pune në Stamboll, e cila vizitë është organizuar nga z.Levent Buş, Zëvendëskryesues i Kuvendit të Komunës së Prizrenit.

Me këtë rast, znj.Gori me bashkëpunëtorët e saj zhvilluan takime të shumëta me udhëheqës institucionesh dhe staf akademik e mjekësor.

Delegacioni i OIK është mirëpritur në Universitetin Publik të Stambollit - Cerrahpaşan nga Prodekani Prof. Dr. İlker İnanç Balkan dhe sekretari i Fakultetit të Mjekësisë, z.Oğuz Hamza Yılmaz.

Takime të frytshme dhe me interes të madh ishin edhe ato në pjesën spitalore të Universitetit, ku takimet vazhduan me kryemjekun Asoc. Dr.Emin Köse, zëvendës kryemjekun Dr. Lektor Muhammed Fatih Şimşekoğlu, Menaxherin e Shërbimeve të Infermierisë Beyhan Budak, zëvendës drejtorët e shërbimeve Infermiore Özkan Karadede dhe Esen Çavuşlu.



## OIK pjesmarrëse në Asamblenë e përgjithshme të EFN-së Bruksel, 12 prill

**Bruksel, 12 prill**

Delegacioni kosovar i udhëhequr nga kryetarja e OIK, znj. Nexhmije Gori është mirëpritur nga Presidenti i EFN-së, Aristides Chorattas, i cili në Bruksel hapi Asamblenë e Përgjithshme të EFN-së, e 118-ta me radhë. Në takim kanë marrë pjesë vendet anëtare të EFN-së, kurse Kosova po synon anëtarësimin me të drejta të plota në këtë organizatë.





## OIK dhe Prisiq me marrëveshje për sigurime shëndetësore për komunitetin infermieror

**Prishtinë, 27 shkurt**

Oda e infermierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësorë ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me kompaninë Prisiq e cila do të ofrojë pako të sigurimeve shëndetësore për të gjithë anëtarët e OIK. Sipas marrëveshjes së arritur mes OIK dhe Prisiq, gjithë komuniteti infermieror, mamitë dhe profesionistët tjerë shëndetësor si dhe familjarët e tyre të ngushtë, do të kenë mundësi të marrin po të njejtën zbritje për pakot e sigurimeve shëndetësore sikurse punonjësit e kompanisë Prisiq. Marrëveshja do të jetë për një periudhë minimale 5 vjeçare, kur edhe mund të rishikohen çmimet dhe kushtet e marrëveshjes.



## OIK mbajti Kuvendin e IV të Legjislaturës së III-të

**Prishtinë, 23 shkurt**

Oda e infermierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësorë ka mbajtur Kuvendin e IV të legjislaturës së III-të. Punimet e Kuvendit i hapi kryetarja e OIK, znj. Nexhmije Gori, e cila i ka përshëndetur të pranishmit dhe i ka falënderuar për punën dhe angazhimin e tyre në zhvillimin dhe avancimin e OIK-ut. Kryetarja Gori në kuadër të raportimit të saj para Kuvendit, ka folur për aktivitetet e zhvilluara gjatë vitit 2023, përfshirë edukimin e vazhdueshëm, takimet regjionale, menaxhimin e Fondit të Solidaritetit si dhe menaxhimin financiar brenda OIK. Profesor Hysni Bajrami, këshilltar në OIK ka thënë se në OIK po rritet çdo ditë llogaridhënia kundrejt përgjegjësisë, duke ngritur kështu një demokraci të brendshme. Në kuadër të ndryshimeve profesor Bajrami ka paralajmëruar kod të ri etik që do të jetë shumë më specifik për



infermierinë. Ndërkohë, kryetarja e OIK Nexhmije Gori tha se nga data 14 deri me datë 23 nëntor 2023 janë mbajtur aktivitetet e Edukimit të Vazhdueshëm Profesional.


Në këtë Kuvend u shqyrtuan dhe me shumicën e votave u miratuan:

- Raporti i punës së OIK-ut për vitin 2023
- Plani i punës për vitin 2024
- Raporti financiar për vitin 2023
- Rregullorja për Edukimin e Vazhdueshëm Profesional.

## OIK themelon zyrën për licencim dhe rilicencim të psikologëve klinikë, logopedëve dhe ergoterapeutëve

**Prishtinë, 06 shkurt**

Oda e infermierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësorë ka hapur zyrën për licencim dhe rilicencim të psikologëve klinikë, logopedëve dhe ergoterapeutëve. Udhëheqëse e kësaj zyreje është zgjedhur zonja Donika Shahini Lami, psikologe me përvojë shumë vjeçare e cila deri më tani ka qenë pjesë e komisioneve të rëndësishme të OIK. Zyra për licencim dhe rilicencim të psikologëve klinikë, logopedëve dhe ergoterapeutëve do të asistojë dhe do t'iu japë ndihmë psikologëve klinikë, komisioneve për licencim të psikologëve klinikë si dhe bazuar në planin e punës harton raporte periodike për zyrën. Po ashtu, kjo zyrë koordinon edukimin e vazhdueshëm profesional dhe inicion tek organet e OIK gjitha propozimet në lidhje me aktet normative për licencim dhe rilicencim të psikologëve klinikë.



## OIK ka zgjedhur gjashtë koordinatore rajonal

**Prishtinë, 07 shkurt**

Oda e Infermierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësorë ka zgjedhur gjashtë koordinatore rajonal, të cilët do të jenë adresë e parë për çështje infermirore për infermierët e gjitha rajoneve të Kosovës. Koordinator i OIK për regjionin e Gjakovës është zgjedhur z. Liridon Marku, në regjionin e Pejës koordinatore është zgjedhur znj. Sabrije Kelmendi Bardhaj, në regjionin e Prizrenit znj. Mirlinda Baliqi, në Gjiçan znj. Sadije Ismaili, në Ferizaj z. Rexhep Jakaj dhe Mitrovicë z. Arban Behrami. Koordinatorët e OIK në rajonet që mbulojnë do të jenë përgjegjës që t'i koordinojnë aktivitetet e OIK. Po ashtu ata do të hartojnë planin programin dhe aktivitetet periodike si ato mujore dhe vjetore të Odës.





## Vonesa gjuhësore, koha para ekraneve dhe ndërhyrja logopedike



### EGZONA FAZLIU

Ne po jetojmë në një epokë digjitale dhe përfshirja e pajisjeve të mençura në jetën e përditshme të fëmijëve është bërë gjithnjë e më e zakonshme, duke ndikuar në përvojat, ndërveprimet

dhe fushat e zhvillimit të tyre. Me prezantimin e pajisjeve të tilla si: telefon, tablet, televizor, kompjuter dhe pajisje të tjera elektronike, qasja e fëmijëve në informacion, përmbajtje edukative dhe lidhja me botën janë transformuar. Megjithatë, përveç përfitimeve të teknologjive moderne, studimet tregojnë që ekzistojnë shqetësime për ndikimin e tyre në zhvillimin e fëmijës dhe atë dukshëm në përvetësimin e gjuhës dhe aftësitë e komunikimit.

Vonesa e gjuhës dhe të folurit shfaqet kur një fëmijë nuk zhvillon gjuhën dhe të folurit në normën e pritur që i përket moshës së tij/saj, manifestuar kështu me një të kuptuar të mirë të gjuhës (gjuha receptive) por aftësinë e të shprehurit (gjuha ekspresive) pak të zhvilluar.

Fëmijët mësojnë se si të flasin nëse inkurajohen të flasin, ndërsa nëse ata janë thjeshtë duke parë një ekran, do të dëgjojnë shumë fjalë por ata nuk do praktikojnë të folurit, nuk do të thonë fjalë ose të kenë ndërveprim "marr-jap" informacione, kështu fëmija do të jetë vetëm një "spektator" që nuk e ka mundësinë të komunikoj dhe të bashkëveproj por vetëm të shikoj dhe dëgjoj.

Studimet tregojnë për efektet e dëmshme të kohës pasive para



ekraneve. Foshnjat që kalojnë më shumë se dy orë gjatë ditës para televizorit janë më të predispozuar që të kenë vonesë të të folurit dhe fëmijët që kalojnë kohë duke përdorur telefon, tablet apo pajisje tjera elektronike do të shfaqin vonesë gjuhësore. Ekspertët bëjnë thirrje që për çdo 30 minuta më shumë që kalojnë në këto pajisje do të ketë një rritje prej 49% të zhvillimit të vonesës gjuhësore.

Një fëmijë 3 vjeçar me vonesë gjuhësore, ka një fjalor shumë të kufizuar dhe gjatë komunikimit dominojnë më shumë gjestet, kurse një fëmijë rreth moshës 5 vjeç me problematikë të tillë ka një të kuptuar të mirë, mirëpo fjalori i tij është i varfër, përdorë më shumë gjestet dhe kuptohet vetëm nga prindërit.

Koha para ekraneve do t'i limitoj lëvizjet e fëmijës. Ekranet dhe videot nuk e zëvendësojnë interaksionin "ballë për ballë" për të mësuar gjuhën dhe komunikimin. Fëmijët nën moshën 3 vjeç e kanë të pamundur të ndërlihdin atë se çfarë ndodhë në ekran me atë të jetës reale. Ata nuk e dinë se çfarë është e vërtetë!

Ndërveprimi prind-fëmijë (komentojmë bashkë se çfarë po shohim në TV) mund të kompensojë disa nga efektet negative, megjithëse është e rëndësishme që foshnjat dhe të vegjëlit të kenë shumë vëmendje dhe stimulim pa ekrane elektronike në mënyrë që të zhvillojnë aftësitë e komunikimit dhe ato sociale.

Ndër të tjera koha e tepërt para ekraneve të fëmijët është lidhur edhe me probleme me gjumin, vështirësitë në shkollë, kujtesën dhe vëmendjen, si dhe aftësinë për të rregulluar emocionet.

Fëmijët mund të referohen për të marrë terapi të të folurit nëse ata kanë ndonjë çrregullim të gjuhës që ndikon në aftësinë e të mësuarit si të flasin, si të emërtojnë objekte,

si të vendosin fjalët për të krijuar fjali apo nëse kanë çrregullime të artikullimit të fjalëve.

### "Le të presim, e të shikojmë"

Identifikimi dhe ndërhyrja e hershme janë vendimtar për tejkalimin e vështirësive që fëmijët mund të hasin gjatë rrugëtimit të tyre nëpër etapat e zhvillimit, përfshirë aftësitë e komunikimit si aftësi jetike. Në disa raste "prit dhe shiko" mund edhe të jetë këshilla e duhur por i vetmi që duhet ta japë këtë këshillë është një logoped. Ndonjëherë, gjatë vlerësimeve rekomandohet që të presim disa muaj nëse mendohet që fëmija është në drejtimin e duhur. Megjithatë do të rekomandohet një përcjellje e zhvillimit të tij përmes vlerësimit tjetër pas 3 muajsh. Kjo është kohë e mjaftueshme për të parë ndryshimin nëse ka ndodhë, por gjithashtu jo shumë kohë nëse nuk shihet progres në mënyrë që të vazhdohet tutje me ndërhyrjen e nevojshme.

Kjo ndërhyrje fillon që nga edukimi dhe këshillimi i prindërve përmes informacioneve mbi ndikimin e kohës pasive para ekraneve në shfaqjen e vonesës së të folurit apo asaj gjuhësore, ofrimin e alternativave se si të nxisin apo stimulojnë të folurit e fëmijës së tyre duke reduktuar/eliminuar kohën para ekraneve dhe duke zëvendësuar atë me kohë interaksioni "ballë për ballë".

Andaj, të fokusohemi në ndryshimet që mund të bëjmë që të ndihmojmë fëmijët të zhvillohen dhe të rriten. Nëse ka shqetësime mbi aftësitë gjuhësore të fëmijës duhet konsultuar një logoped. Prindërit këshillohen të ndjekin instiktet e tyre mbi shqetësimet e mundshme që ndjejnë për fëmijën dhe të informohen mbi atë që përdorimi i tepër i këtyre pajisjeve mund të ndihmojë në shfaqjen e vonesave gjuhësore, të përkeqësoj ato apo të kufizoj përmirësimin e tyre.





## Kujtime të infermierëve nga koha e luftës II

*Secila periudhë e shërbimit profesional për infermierët, mamitë dhe profesionistët tjerë shëndetësorë është e veçantë. Por, janë të jashtëzakonshme kujtimet e infermierëve nga lufta kur ata dhanë maksimumin e tyre në kushte të rrezikshme jete, në shërbim të pacientëve dhe ushtarëve të UÇK-së. Më poshtë, po ju sjellim serinë e dytë të rrëfimeve të disa nga infermierëve, nga koha e luftës më 1998-1999*

### Rexhep Jakaj

Nora Shabani, infermiere, rrëfen se si më 15 prill 1999 u paraqit në Ambulancën Ushtarake në Krojmir, me dëshirën që të pranohej aty për të ofruar kontributin e saj në trajtimin e ushtarëve dhe popullatës civile, që mundësohej në këtë ambulancë. Infermierja Norë, u bë pjesë e kësaj ambulance, që udhëhiqej nga Dr. Jakup Ismajli. Aty ishin të angazhuar edhe infermierët tjerë: Musa Baftiu, Bashkim Gashi, Valon Gashi, Ilir Rizani, Lumniqe Gashi, Arbana Qeriqi, Habibe Zeqiri, Merita Iballi, Teuta Iballi, Sara Olluri, Magbule Brahimë etj.

“Kushtet për punë në këtë ambulancë ishin të vështira. Punonin në një tendë. Pacientë kishim shumë e barna fare pak. Gjatë punës sonë në këtë ambulancë përjetuam çaste të mira, kur personeli ynë mjekësor kishte mundësi t’u ndihmonte pacientëve. Por, edhe çaste të vështira, kur nuk kishte mundësi për shkak të mungesës së barnave apo mjeteve të nevojshme mjekësore”, rrëfen infermierja Nora Shabani, për ditët e

vështira të kaluara në këtë ambulancë ushtarake.

Ajo kujton muajin maj të vitit 1999, kur nga zonat e tjera të luftës, në Krojmir, ishin dërguar afërsisht 150 njerëz të plagosur rëndë, të cilët u ndalën aty kalimthi derisa po bënin rrugën për në Tetovë, ku shkonin për shërim apo trajtim të mëtejshëm. U tmerrova kur pashë ushtarë dhe civilë të plagosur e të sakatuar, të cilëve u mungonin shumë pjesë të trupit. Nuk mund ta harroj Drenushën e vogël 6 vjeçare, e cila nga minahedhësi kishte humbur një dorë. Gjatë qëndrimit tim në UÇK kam përjetuar shumë momente të rënda, rrëqethëse, të cilat fatkeqësisht ishin të përditshme”, rrëfen infermierja Nora Shabani.

Infermieri Rifat Sejdiu u angazhua në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës më 7 prill 1999 si 18 vjeçar. Ai sapo kishte mbarimuar shkollën e mesme të mjekësisë dhe nuk kishte ndonjë eksperiencë të punës. “Të ballafaqohesh me situata nga më të ndryshmet e më të rëndat

mjekësore, nuk ishte edhe punë e lehtë”, rrëfen Rifati.

Ishte muaji Maj 1999, dhe ai ishte i sistemuar në stacionar (shërbim primar) kur nga zonat e Drenicës u transferuan në Zonën Operative të Nerodimes mbi 100 të plagosur. “Në anën tjetër, në ambulancën tonë kishim të shtrirë një numër të kosiderueshëm të ushtarëve të plagosur, por në mesin e tyre kishte edhe civilë. Ishte rasti im i parë të ballafaqohem me aq shumë të plagosur nga llojet e ndryshme të artilerisë serbe. E mbaj mend një pacient, të cilit ia kam harruar emrin, që kishte disa plagë në trup, e njëjën prej tyre e kishte në këmbë. Plaga nuk ishte pastruar me ditë të tëra, e ushtari, ashtu si gjithë të tjerët, ishte i lodhur fizikisht dhe psikikisht. Në momentin që e bëmë hapjen e plagës, i shihej ashti i këmbës, ngaqë plaga ishte e madhe dhe e thellë. Gjithashtu, prej saj filluan të dalin krimbat. Ishte ndjenjë shumë e keqe për mua, por edhe frikë, sepse nuk isha ballafaquar me përvoja të tilla. E pastruam plagën, i larguam krim-



bat thuajse një nga një dhe dhimbja e të plagosurit ishte e padurueshme. Ishte vullneti dhe dëshira për ta ndihmuar të plagosurin që më dhanë forcë ta tejkaloja atë situatë dhe pas rekomandimit të mjekut, t'i jepja një analgjetik në formë injeksioni pacientit", rrëfen ai.

Ky ishte injeksioni i parë që Rifati do t'i jepte një pacienti, i cili duket se e kishte vërejtur këtë.

Në Zonën Operative të Nerodimes ka



shërbyer edhe Hasime Ademaj, nën përkujdesjen e komandantit Shefket Muhadini, i cili ndonëse i plagosur rëndë, - kishte një moral të lartë dhe i inkurajonte ushtarët se do të shërohen dhe të gjithë së bashku do të vazhdojnë rrugën drejt çlirimit të vendit.

"Komandant Shefket Muhadini (i njohur si Tamuli) kishte marrë plagë të rënda, ndërsa unë, fatkeqësisht, isha e vetmja infermiere, pa ndihmë të stafit mjekësor, përpqesha të ofroj ndihmën time me aq sa isha e përgatitur për shërbime kirurgjikale. Në ato kushte të vështira të luftës edhe përkundër ndihmës së pakursyer profesionale, komandanti nuk arriti t'iu përballojë plagëve të rënda. Por morali i tij ishte shumë i lartë pavarësisht gjendjes së rëndë që e çoi deri në vdekje", rrëfen Ademaj.

Në fillim të vitit 1999, radhëve të UÇK-së iu bashkua edhe Hazire Kashtanjeva që u angazhua në Spitalin Ushtarak të ZON-së si infermiere. Kur e kujton periudhën e luftës në spitalin ushtarak, Hazirja

sa është e emocionuar, aq edhe ndihet krenare për këtë periudhë të lavdishme të historisë sonë.

"Inkuadrimi në radhët e ushtrisë ka qenë një përvojë e veçantë. Aty do të ballafaqoheshim jo vetëm me të vrarë, por edhe me të plagosur rëndë, me luftëtarë që humbën gjymtyrët e trupit në beteja" thotë ajo. Ndërsa e kujton përfundimin e luftës, shton se një grup nga stafi i spitalit ushtarak kanë zbritur në qytetin e Ferizajt për ta vëzhguar hapësirën, nëse ka kushte për t'i transferuar të plagosurit që i kishin aty.

"Pasi i kishin marrë çelësat e spitalit me vete nga uzurpatorët, erdhën me një veturë të cilën gjatë rrugës e kishin mbuluar me lule popullata, sa që edhe ngjyra e veturës mezi dallohej. Momentin kur u afruan te Spitali Ushtarak ata filluan

t'i bien borisë aq fuqishëm sa që dolën të gjithë jashtë. Kur ndaloi vetura buçiste një këngë me motive patriotike dhe të gjithë filluam të vallëzojmë në oborrin e spitalit. U bashkuan edhe të plagosurit, në mesin e tyre edhe ata me nga një këmbë. Aty të gjithëve iu rrodhën lotët, mirëpo ata ishin lot gëzimi që Kosova u çlirua, por edhe lot dhimbjeje duke i shikuar ushtarët e plagosur e të gjymtuar duke vallëzuar", tregon Hazire Kashtanjeva - Osmani.

Ishin këto vetëm disa nga rrëfimet e infermierëve që iu përgjigjën thirrjes së ndërgjegjes për t'i vënë aftësitë e tyre profesionale në shërbim të luftës për çlirimin e vendit nga pushtuesit. Me punën e tyre, edhe pse nuk ishin në fushën e betejës përballë armikut, ata u bënë dëshmitarë të një realiteti tjetër, prekës dhe po aq të hidhur. I panë të sfiliteshin nga dhimbjet luftëtarët e lirisë, të shuheshin jetët e atyre që në front ishin tmërri i armikut, u detyruan të bëjnë të pamundurën për t'i mbajtur

në jetë, morën aq e aq amanete për t'u përcjellë familjarëve, e mbi të gjitha, u bënë shpresa e vetme për rikthim në jetë, për të pritur agun e lirisë.

Rrefimi i infermieres Linda Fetahu, e cila pas 20 vitesh viziton një shpellë ku kishin mjekuar civilë dhe ushtarë të UÇK-së.

"Edhe sot pas 20 viteve, shohim gjurmë të ushtarëve të shtrirë në këtë shpellë e këtë e dëshmon kjo batanije e të plagosurve e cila edhe sot është këtu", rrëfhet ajo. Në mesin e të plagosurve ajo kujton një 15 vjeçare, L.T., së bashku me vëllaun e saj. Ajo kishte 17 plagë në trup. Kishte humbur njëren këmbë dhe njërin sy", rrëfen Fetahu.

Zëri i pacientes edhe sot e përcjell infermierën Linda Fetahu.

Ajo tregon se problemi më i madh në shpellën ku mjekonin pacientët ishte mungesa e ujit dhe ushqimit. "E kemi pasur të vështirë, sepse ne nuk kishim as material e as pushim për vete që ishim të rraskapitur. Në shumicën e rasteve e kemi pasur edhe rolin e infermieres edhe të nënës", rrëfen Fetahu.

Infermierja Zaide Hashimi Bytyçi, ish-pjesëtare e UÇK-së, e cila u fejua dhe martua pasi u dashurua në ushtarin e UÇK-së, tash bashkëshortin e saj, të cilit ia mjekoi plagët. Zahidja thotë se atdheut mund t'i shërbehet në çdo kohë dhe në mënyra të ndryshme.

"Si ushtarë e UÇK-së, kisha rastin vetëm një herë në jetë, të jesh infermiere në luftë përveç që ishte nder e krenari, ishte edhe obligim i madh. Roli i infermierisë i kalonte limitet e profesionit dhe humanizmit. Ne nganjëherë duhej të ishim mjek, këshillues, nënë, motër, kuzhinierë e pastruese e rrobave të të plagosurve. Kujdesi ynë ndaj popullatës civile dhe ushtarëve, trajtimi i të plagosurve, bartja e tyre dhe strehimi në vende më të sigurta, e bënë profesionin tonë më të çmueshëm dhe më meritore për Lirinë që sot e gëzojmë", përfundon Zahidja.



# MENAXHIMI I KOMUNIKIMIT TË PERSONELIT SHËNDETËSOR ME PACIENTËT, SFIDAT DHE PROBLEMET

LIRIJE BEQIRI



Hulumtimet e shumta kanë treguar se pavarësisht se sa të ditur mund të jenë me një klinikë personeli shëndetësor, nëse nuk janë në gjendje të bëjnë komunikim të mirë me pacientin, nuk do të jenë efikas (McCabe, 2004). Sikurse në shumë vende të botës, edhe në Kosovë ekzistojnë probleme dhe vështirësi në komunikimin ndërmjet profesionistëve shëndetësorë dhe pacientëve. Pacientët në Kosovë shpeshherë kanë shprehur shqetësimet e tyre në lidhje me zhvillimet në sektorin e shëndetësisë, përdorisa ka ankesa rreth komunikimit jo-profesional në institucione shëndetësore (Asnani, 2009). Profesionistët shëndetësor dhe bashkëpunëtorët profesional në mungesë komunikimi adekuat mund edhe të dëmtojnë marrëdhënien pacient-personel shëndetësor, pasoja që mund të rezultojnë në diagnozë të gabuara dhe gabime të tjera mjekësore që mund të çojnë në morbiditet dhe mortalitet (van Dijk et al., 2023).


## Qëllimi i hulumtimit

Qëllimi kryesor i këtij hulumtimi është pasqyrimi i gjendjes reale sa i përket komunikimit ndërmjet profesionistëve shëndetësorë dhe pacientëve. Punimi synon të prezantojë disa prej problemeve kryesore që kanë pacientët gjatë komunikimit me mantel-bardhët dhe anasjelltas gjithashtu edhe krahasimi me hulumtimin e realizuar në vitin 2014.

## METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Ky është një studim kros-seksional (transversal), ku është konsultuar literaturë shkencore që ka të bëjë me komunikimin shëndetësor si dhe janë realizuar intervista me pacientët e shtrirë në klinikat e QKUK. Përzgjedhja e pacientëve dhe profesionistëve shëndetësor është bërë sipas metodës së rastit. Për të siguruar anonimitet të plotë për pacientët të intervistuar nuk është paralajmëruar personeli shëndetësor. Numri i të anketuarve për këtë hulumtim është 300, prej tyre pacientë 204 dhe 96 staf shëndetësor ku prej tyre 125 femra dhe 77 meshkujt. Intervistat ishin plotësisht anonime, duke u cekur vetëm klinika se ku është zhvilluar intervista. Përpunimi i të dhënave është realizuar përmes MS Excel

## Rezultatet nga Pacientët




Në figurën e paraqitur (1), shfaqen të dhëna që tregojnë mbi nivelin e kënaqshmërisë së komunikimit ndërmjet pacientëve dhe stafit shëndetësorë. Më shumë se gjysma e pacientëve të intervistuar kanë deklaruar që janë aspak ose pak të kënaqur (53%) ndërsa 40% prej tyre janë ose të kënaqur ose shumë të kënaqur me nivelin e komunikimit.

Fig.1. Sa jeni të kënaqur me komunikimin e mjekëve dhe infermierëve me juve?


Tutje, pacientët janë pyetur se sa herë ndodhë që profesionistët shëndetësorë të përdorin gjuhë apo terme që janë të vështira për t'u kuptuar. Rezultatet e graf. 2 tregojnë që shumica e pacientëve (72%) deklarojnë që profesionistët shëndetësorë përdorin terme të tilla ndërsa vetëm 8% theksojnë që asnjëherë nuk ka ndodhur kjo.

Fig.2.A mund të na tregoni sa herë ju ka ndodhur që mjekët dhe infermieret përdorin terminologji profesionale?





### Rezultatet nga Stafi i Profesionistëve Shëndetësorë




Sa kohë ndani për të komunikuar me pacientë?

Edhe pse më shumë se gjysma e pacientëve nuk janë të kënaqur me komunikimin e mjekëve dhe infermierëve, këta të fundit deklarojnë që ndajnë një kohë të konsiderueshme për të biseduar me pacientët e tyre. Rezultatet e paraqitura në figurën 3 tregojnë se 38% e profesionistëve shëndetësorë të intervistuar ndajnë 5-10 min kohë për komunikimin me pacientët, ndërsa një numër i përafërt i tyre raportojnë të kalojnë deri në 60 min për të biseduar me pacientë (36%).

Fig.3. Sa kohë ndani për të komunikuar me pacientë?

Tek pyetja se cila është mënyra e informimit që profesionistët shëndetësorë përdorin që të informojnë pacientin për sëmundjen apo diagnozën që ka, pothuajse se gjysma e tyre (48%) deklarojnë që përdorin një gjuhë që është e kuptueshme për pacientë ndërsa 24% prej tyre theksojnë që i referohen diagnozës mjekësore.

Fig.4. Cila është mënyra e informimit që ju përdorni të pacientit për sëmundjen apo diagnozën që ka?



### Krahasimi i hulumtimeve të viteve 2014 -2024

Në pyetjen se sa kohe shpenzojnë stafi shëndetësor për të komunikuar me pacientë në hulumtimin e vitit 2014, 33% e stafit deklarohet se shpenzojnë një orë duke biseduar me pacientët, kurse në vitin 2024, 38% e stafit komunikojnë vetëm 5-10 min. me pacientë. Në pyetjen se sa herë mjekët e infermierët përdorin terminologji mjekësore gjatë transmetimit të diagnozës në vitin 2014 pacientët deklarojnë se 64 % e tyre shpesh e përdorin terminologji mjekësore kurse në vitin 2024 edhe më shpesh e përdorin terminologjinë mjekësore pra 72% e tyre . Në vitin 2014 në pyetjen se cila është mënyra e informimit nga ana e stafi shëndetësor rreth sëmundjes së pacientit, 57% e tyre deklarojnë se përdorin gjuhën e pacientit, kurse në viti 2024 gjuhën e pacientit e përdorin 48% e tyre.

### KONKLuzionet

Në këtë hulumtim janë nxjerrë pikat kyçe duke përfshi problemet aktuale sa i përket komunikimit, qofshin problemet që hasin nga profesionistët shëndetësorë, ashtu dhe nga pacientët. Punimi ofron argumente për gjendjen aktuale dhe rekomandimet për masat që duhet të ndërmerren për ta përmirësuar komunikimin shëndetësor. Dekurajimi i bashkëpunimit - profesionistët shëndetësor sipas të dhënave të dala nga hulumtimi arrijnë të dekurajojnë pacientët që të shprehin shqetësimet dhe pritjet e tyre si dhe koha që ata vënë në dispozicion për të dëgjuar kërkesat e pacientëve. Ky bashkëveprim dekurajues pengon pacientët për të pohuar nevojën e tyre për informacione dhe shpjegime shtesë. Bazuar në periudhën kohore, dhjetë vjeçare të hulumtimit nuk vërehet ndonjë ndryshim apo përmirësim në procesin e komunikimit!

### REKOMANDIMET

**Trajnime të vazhdueshme** – aftësitë e komunikimit duhet zhvilluar në vazhdimësi për të ngritur nivelin e trajtimit.

**Ruajtja e informatave personale të pacientëve** – rreth sëmundjes që ka pacienti dhe alokimi i përgjegjësishë në qasje në informacione në mënyrë që humbja e besimit nga ana e pacientit ka lidhje direkte në trajtimin e tyre.

**Hulumtimet e vazhdueshme** – përpos trajnimeve profesionale duhet të kemi kujdes edhe në mekanizmat e informimit rreth kualitetit të shërbimeve të ofruara (përfshirë komunikimin) duke përdorur pyetësor me qëllim përmirësimin e shërbimeve.



# NDIKIMI I FAKTORËVE TË MOTIVIMIT NË KËNAQËSINË NË PUNË TE INFERMIERËT E KLINIKËS SË PEDIATRISË TË QENDRËS KLINIKE UNIVERSITARE TË KOSOVËS

Vlora Sopi



**Hyrje:** Kënaqësia në punë është një prej aspekteve më të studiuar në psikologjinë e organizatës dhe të industrisë, ajo është studiuar gjerë e gjatë në shumë fusha. Prandaj, ka shumë definicione të kënaqësisë në punë dhe me punën dhe është vështirë që të përcaktohet për njërin nga ata. Shumica e shkencëtarëve, sidoqoftë, pajtohet se kënaqësia me punën është mënyra në të cilën një individ e sheh vendin e tij të punës. Për disa, ajo është niveli deri te i cili një individ e përjeton vendin e tij të punës si kënaqësi. Pra, pavarësisht nga diferencat në përkufizim, në esencë kënaqësia me punën nënkupton qasjen që e merr një individ dhe bindjen që e krijon ai për vendin e tij të punës. Infermierët përbëjnë pjesën më të madhe të punëtorëve shëndetësor. Përtej kësaj, ata janë kontakti i parë dhe më i gjatë i drejtpërdrejt me të sëmurin. Nga ky aspekt niveli i kënaqësisë së tyre me punën është shumë e rëndësishëm për performancën, por edhe imazhin e të gjithë sistemit.

Një prej teorive më të njohura që shpjegojnë kënaqësinë me punë është teoria e hierarkisë e njohur si teoria e nevojave apo teoria Maslow. Sipas kësaj teorie nevojat e njeriut janë të radhitura në pesë shkallë. Shkalla e parë në këtë hierarki është e nevojave fiziologjike. Përbushja e këtyre nevojave është e domosdoshme që një individ të mbijetojë. Që kjo shkallë të përbushet, paga dhe benefitet që punëtorit i paguhen nga organizata duhet të përbushin nevojat e tij bazike, respektivisht nevojën për ushqim, strehim dhe veshmbathje.

Shkallë e dytë në hierarki e bënë ndjenja e sigurisë në vendin e punës. Kjo siguri perceptohet si siguri fizike, financiare dhe si gjendje e mirëqenies fizike dhe sociale si dhe në shëndet dhe sëmundje.

Shkalla e tretë në hierarkinë e Maslow është e ndjenjës së përkatësisë organizatës. Kjo e fundit shihet përmes raporteve të punëtorit me kolegët dhe mbikëqyrësit e tij.

Shkalla e katërtë në hierarki janë vlerësimi dhe mirënjohja nga organizata, ndërsa e pesta, më e larta, është e ndjenjës së kompletimit ose e vetë-aktualizimit, respektivisht ndjenja e përbushjes së vetvetes.

Matja e kënaqësisë me punë mund të bëhet në tre mënyra – me një pyetje të vetme, me matje globale dhe me matje të aspekteve të ndryshme të kënaqësisë me punën të mbledhur në grupe.

Matja me një pyetje të vetme, zakonisht nënkupton se punëtori është pyetur nëse është i kënaqur me punën e tij dhe se është përgjigjur me “po” ose “jo”, respektivisht me “aspak”, “jo”, “edhe po edhe jo”, “po” dhe “shumë”, varësisht nga thellësia me të cilën bëhet studimi.

Matja e kënaqësisë së përgjithshme (globale) me punën bazohet në një numër pyetjesh të lidhura me pagesën, kushtet e punës dhe mundësinë për të përparuar në karrierë. Pikat e fituara nga përgjigjet

e japin kënaqësinë e përgjithshme (globale) me punën. Nga ana tjetër, matja e kënaqësisë me punën e bazuar në aspektet e ndryshme të saj (fusha, faqete) bëhet duke shtruar pyetje të grumbulluara në grupe, të lidhura me pagesën, promovimin, mbikëqyrjen dhe bashkëpunimin me kolegë dhe duke vlerësuar me pika secilin nga grupet.

Dhe teoria tjetër është teoria bifaktoriale e Herzbergut, sipas kësaj teorie kënaqësia me punën dhe pakënaqësia me të janë dy fenomene që nuk janë të lidhura në mes vete. Sipas kësaj teorie nëse një punëtor nuk është i pakënaqur me punën, nuk do të thotë se është i kënaqur me të. Quhet teori bifaktoriale sepse një dy grupe të faktorëve që e rritin kënaqësinë me punën ose e zvogëlojnë atë. Grupi i parë është grupi i faktorëve motivues ose të brendshëm, ndërsa grupi i dytë është grupi i faktorëve demotivues, të quajtur edhe të jashtëm ose higjienikë. Faktorët e brendshëm ndikojnë fuqishëm në motivimin dhe kënaqësinë e punëtorit me punë. Të tillë janë mirënjohja për punën, promovimi dhe përparimi në karrierë. Faktorët e jashtëm, nga ana tjetër, si paga, kushtet e punës, politikat e kompanisë, siguria në punë, kanë potencial të madh për të demotivuar punëtorin nëse nuk i përgjigjen pritjeve të tij. Këta faktorë të jashtëm, të quajtur edhe faktorë higjienikë, po që se janë në nivel të lartë ndikojnë në kënaqësinë me punë dhe e rrisin motivimin për të.

**Qëllimi i punimit:** Qëllimi i këtij punimi është që të hulumtojmë ndikimin e faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm në kënaqësinë e infermierëve në Klinikën e Pediatrisë të QKUK me punën dhe të identifikojmë determinantet që e përcaktojnë kënaqësinë me punën.

**Metodologjia:** Studimi është realizuar në Klinikën e Pediatrisë të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës bazuar në një anketë të dizajnuar në mënyrë të posaçme për këtë qëllim. Në anketë janë përfshirë 50 infermierë të zgjedhur me metodën e rastit (të randomizuar). Anketa ka tre pjesë. E para përmban të dhëna sociodemografike dhe është e dizajnuar nga autori, ndërsa e dyta është anketë standarde e shkallës së kënaqësisë sipas McCloskey/Mueller (MMSS, McCloskey/Mueller Satisfaction Scale). E treta studjon raportet mjek/infermier.

Të dhënat janë vlerësuar në shkallë sipas klasifikimit të Likert. Raportet mjek/infermier janë vlerësuar bazuar në faktor personal, faktorët e organizimit dhe ata të bashkëpunimit në punë. Niveli i kënaqësisë i matur sipas MMSS ka pesë opsione, ku: 1 ka domethënien “shumë i pakënaqur”, 2 “i pakënaqur”, 3 “neutral”, 4 “i kënaqur” dhe 5 “shumë i kënaqur”. Niveli i kënaqësisë si dhe kategorizimit të faktorëve sipas Likert gjithashtu ka pesë opsione, ku: 1 ka domethënien “aspak i rëndësishëm”, 2 “i parëndësishëm”, 3 “neutral”, 4 “i rëndësishëm” dhe 5 “shumë i rëndësishëm”. Për të inkurajuar pjesëmarrësit që të marrin qëndrime në lidhje me pyetjet dhe jo të fshihen prapa përgjigjes “neutral”, në pyetësor e kemi eliminuar këtë opsion. Pra i kemi modifikuar të dy pyetësorët.

Sipas kësaj klasifikimi faktorët e brendshëm (intrinsic) janë: perceptoni i punës si e rëndësishme, sfiduese dhe interesante, niveli i përgjegjësisë në punë, mundësia e përparimit në punë si dhe perceptoni i vetë profesionit. Këta faktorë ndryshe quhen edhe motivues. Ndërsa, faktorët e jashtëm (ekstrinsic) janë: paga, statusi në vendin e punës, siguria e vendit të punës (lloji i kontratës, a është puna e përkohshme apo ne kohë të pacaktuar), kushtet e punës, përfitimet shtesë ose bonuset, politikat dhe praktikatat administrative të organizatës dhe marrëdhëniet ndërmjet njerëzve. Këta faktorë quhen ndryshe edhe faktorë higjienikë dhe në esencë, sipas Herzberg janë demotivues. Koha e shpenzuar për anketë ka qenë rreth 10 minuta, ajo ka qenë plotësisht anonime. Anonimiteti ka supozuar objektivitet më të lartë të rezultateve të fituara.

Përgjigjet e fituara me anketë do të janë përpunuar në mënyrë statistikore duke përdorë programin SPSS 22.0.0.0 (2016) dhe janë komentuar duke u ballafaquar me praktikatat dhe standardet në regjion.

**Rezultatet:** Në studim kanë marrë pjesë 50 infermierë. Moshë mestare e të anketuarve ka qenë 41 vjet. Më shumë se gjysma e të anketuarve kanë qenë me nivel bachelor (46%) ose kanë vijuar studimet master (10%). Të gjithë të intervistuarit kanë qenë të gjinisë femrore. Më të kënaqur me punën kanë qenë të anketuarit e moshës mbi 50 vjet (91%), infermierët e nivelit të mesëm (40%), ata me më shumë se 20 vjet përvojë pune (93%) dhe ata me të ardhura mujore në familje më të vogla se 500 euro (42%). Kënaqësia me vendin e punës (84%), mundësia për të përparuar në karrierë (76%), raporte e mira ndër njerëzore (86%), pjesëmarrja në vendimarrje (72%), perceptoni i punës si e rëndësishme (62%) dhe ndjenja e arritjes personale (84%), kanë qenë faktorë të brendshëm që kanë dominuar anketën. Kënaqësitë me pagën (32%), me pagesën shtesë (32%), me kushtet në dhomat e pacientëve (36%), me kushtet në dhomat e infermierëve (44%), si dhe me kushtet në mensën e spitalit (20%) kanë qenë më të vogla, dhe kanë dominuar grupin e faktorëve të jashtëm.




### Të anketuarit sipas gjinisë dhe moshës

Pjesëmarrëset në studim ishin të gjitha të gjinisë femrore. Në grafikoni më poshtë kemi prezantuar të anketuarit sipas moshës.

Grafikoni 1. Të anketuarit sipas moshës

Pra, mosha mesatare e të anketuarve është 41.02 vjet me pjesëmarrësen më të re të moshës 30 vjet dhe më të vjetrën të moshës 57 vjet.

Te anketuarit sipas nivelit të shkollimit




sipas shkollimit

### Te anketuarat sipas nivelit të shkollimit


Në grafikoni e dytë kemi prezantuar të anketuarit sipas nivelit të edukimit. Si shihet nga studimi 23 të anketuar ose 46% kanë qenë me edukim të mesëm, 22 ose 44% me edukim të nivelit baçellor dhe 5 të anketuar ose 10% janë duke vijuar ose kanë përfunduar studimet master.

Grafikoni 1. Të anketuarit

### Mosha e te anketuarve



### Te anketuarit sipas përvojës në punë



### Te anketuarat sipas përvojës në punë

Numri mesatar i viteve të punës për të anketuarit ka qenë 19.26 vjet me luhatje në përvojën e punës prej 1 deri 37 vjet.

Grafikoni 1. Të anketuarit sipas përvojës në punë

**Përfundimi:** Infermierët bëjnë pjesën më të madhe të punëtorëve shëndetësor. Më tepër se vetëm si numër, ata janë edhe ajo pjesë e sistemit që përbënë kontaktin e parë dhe më të gjatë me pacientin. Kënaqësia e tyre me punën prandaj është shumë e rëndësishme. Për ta kuptuar këtë kënaqësi dhe në veçanti çka e përcakton atë kemi modifikuar Pyetësorin e McCloskey/Mueller (MMSS, McCloskey/ Mueller Satisfaction Scale) për kënaqësinë me punën dhe ia kemi përshatë kushtet të Kosovës.

Rezultate në të cilët kemi ardhë kanë konfirmuar se infermierët janë më të kënaqur me faktorët e brendshëm se sa me ata të jashtëm. Rezultati ka qenë i pritur dhe është edhe një vërtetim i teorisë së Herzberg se elementet e brendshme të punës janë përcaktues të kënaqësisë me punën, ndërsa elementet e jashtëme të pakënaqësisë me të.

Në kënaqësinë e përgjithshme të infermierëve me punën, ndikimi i faktorëve të motivimit personal në kënaqësinë me punën është treguar më i madh se i atyre të jashtëm, të lidhur me kushtet e punës.

Kur janë në pyetje përvoja në punë dhe moshja e infermierëve të anketuar në korrelacion me kënaqësinë me punën kemi gjetur se sa më e madhe që është moshja e infermierëve dhe sa më shumë përvojë punë që kanë ata, më të kënaqur janë me punën.

Lidhja që ka statusi material i infermierit në studimin tonë ka treguar se sa më të vogla kanë qenë të hyrat në familje, aq më i madh ka qenë satisfaksioni me punën. Kjo nuk është në korrelacion me të dhënat që gjinden në literaturë, por mund ta ketë shpjegimin në faktin se Kosova ka një shkallë të lartë të papunësisë dhe të varfërisë së përgjithshme, respektivisht faktin se në këto kushte të qenit e punësuar do me thënë shumë.

Faktor tjetër që është treguar se ndikonë në kënaqësinë me punën është edhe ngarkesa me punë dhe kushtet e punës. Në studimin tonë katër prej pesë infermierëve të anketuar kanë treguar se numri i pacientëve në departamentin e tyre ose në ambulancën e tyre specialitike është shumë i madh. Pakënaqësia me kushtet e punës, sidogoftë nuk ka ndikuar në mënyrë të rëndësishme në kënaqësinë e përgjithshme me punën, e cila siç kemi përmendur më parë ka qenë shumë e lartë.

Punëtorët shëndetësor ndonëse kanë vlerësuar lartë menaxherët e tyre, madje duke i cilësuar edhe si liderë, nuk janë të kënaqur me pjesëmarrjen në marrjen e vendimeve dhe mënyrën e shpërblyerimit për punën. E njëjta gjë vlen edhe për mungesën pjesëmarrjes në marrjen e vendimeve, autonominë në punë dhe mënyrën e vlerësimit nga menaxherët.

Një tjetër e dhënë që ka dal nga studimi është pakënaqësia me kushtet e punës për punëtorë, hapësirat jo të përshtatshme të punës, mungesa e pajisjeve dhe barnave, për shkak të të cilave infermierët udhëzojnë pacientët për ekzaminime jashtë spitalit janë treguar me rëndësi për kënaqësinë e infermierëve me punën.



# Një rishikim sistematik i kompetencave të infermierisë: Sfidat e sistemeve dhe ndryshimet demografike

Ippolito NOTARNICOLA



Hyrje: Roli i infermierëve pritet të pësojë ndryshime të thella në vitet e ardhshme për shkak të fenomeneve sociokulturore, mjedisore dhe teknologjike në zhvillim të shpejtë. Sipas disa autorëve, kompetenca mund të përkufizohet si “një karakteristikë e brendshme individuale e lidhur me performancën efektive ose superiore në një detyrë ose situatë, dhe e cila matet në bazë të një kriteri të paracaktuar” (Rahmawati et al., 2021; Fu’ad & Aminnudin 2020).

Sa i përket kompetencave infermiere, ato mund të përkufizohen si “një

grup veprimesh komplekse, rezultati i të cilave është të drejtë veprimin infermior në praktikën profesionale, dhe që mund të vlerësohet përmes performancës” (Egerod et al., 2021; Zumstein Shaha & Grace 2023). Përkufizimi dhe vlerësimi i kompetencave infermiere janë thelbësore për të siguruar kujdes të kualifikuar infermior për pacientët dhe për të nxitur zhvillimin profesional (Willman et al, 2020). Por cila është e ardhmja e kompetencave të infermierisë? Cilat fenomene sociokulturore i nënshtrohen? Të gjitha këto dukuri sociokulturore, nga qëndrueshmëria mjedisore te teknologjia, nga inovacioni te globalizimi, nga urbanizimi te politikat e pasigurta dhe evolucioni demografik, do të ndikojnë në zhvillimin e kompetencave të infermierisë në të ardhmen (Tang et al., 2021; Chirisa & Campbell 2023; Awosusi et al., 2022). Në përgjithësi, punët e infermierëve në sektorin publik, me disa përjashtime, luajnë një rol udhëheqës dhe pritet të rriten. Rezultatet tregojnë gjithashtu se rëndësia e shërbimeve thelbësore shëndetësore ka të ngjarë të rritet. Shumë nga këto profesione, përsëri, nuk kërkojnë specializim të lartë. Megjithatë, ato duhet të kombinohen me një infermiere specialiste, të cilën konsumatorët e vlerësojnë gjithnjë e më shumë (Wakefield et al., 2021). Në presim gjithashtu kërkesë të madhe për disa nga ato aktivitetet profesionale të infermierisë, jo të gjitha që pasqyrojnë rritjen e qëndrueshme të shërbimeve shëndetësore (Labrague et al., 2022; Ghowaidi et al., 2022). Në këtë kontekst, shfaqet një tregues i qartë që sistemet e arsimit dhe trajnimit të fokusohen në një lloj kufiri “strukturor” të talentit të njerëzve, “lëkura” e parë brenda së cilës mund të forcohen disa kompetenca dhe karakteristika themelore të personit për të menaxhuar të tjerët si një i përgjithshëm dhe kapacitet dinamik, me synimin për të mësuarit gjatë

gjithë jetës (Burns 2020).

Qëllimi i punimit: Qëllimi i këtij rishikimi të literaturës është të ekzaminoj kompetencat e ardhshme të infermierisë dhe fenomenet sociokulturore që do të ndikojnë në to. Ai synon të ofrojë një kuptim gjithëpërfshirës të proceseve transformuese që formësojnë profesionin e infermierisë dhe kompetencave kyçe të nevojshme për të lundruar në peizazhin e zhvillimit të kujdesit shëndetësor.

Metodologjia: Kërkimi u kufizua në studimet e publikuara brenda 5 viteve të fundit, nga viti 2018 deri në 2023. Kjo kornizë kohore u zgjodh për të siguruar që rishikimi të fokusohet në kërkimet dhe projeksionet më të përditësuar në lidhje me të ardhmen e kompetencave të infermierisë. Kufizimi i kërkimit në 5 vitet e fundit ndihmoi gjithashtu për të kapur ndikimet e fundit dhe të vazhdueshme të ngjarjeve të mëdha globale, si pandemia COVID-19, në profesionin e infermierit dhe kompetencat e nevojshme.

Strategjia e kërkimit u krijua për të qenë mjaft e gjerë për të kapur një gamë të gjerë të literaturës përkatëse, duke qenë gjithashtu mjaft specifike për të përjashtuar studimet që nuk trajtonin drejtpërdrejt temat kryesore me interes. Kombinimi i fjalëve kyçe lejoi kërkimin të identifikonte studime që shqyrtonin kompetencat e infermierisë nga këndvështrime të ndryshme, duke përfshirë ndikimin e ndryshimeve të sistemit të kujdesit shëndetësor, ndryshimet demografike dhe tendencat sociokulturore në zhvillim. Pas kërkimeve fillestare të bazës së të dhënave, rezultatet u kontrolluan për rëndësinë duke rishikuar titujt dhe abstraktet. Studimet që plotësonin kriteret e përfshirjes, përkatësisht ato që fokusoheshin në të ardhmen e kompetencave të infermierisë dhe faktorët që i formësonin ato, u morën më pas në formatin e tekstit të plotë për një rishikim dhe analizë më të detajuar. Duke kryer një kërkim sistematik të literaturës, duke përdorur një metodologji të fortë dhe duke vlerësuar në mënyrë kritike

studimet e përfshira, ky rishikim synon të ofrojë një kuptim gjithëpërfshirës dhe të bazuar në prova për të ardhmen e kompetencave të infermierisë dhe fenomeneve komplekse sociokulturore që do të ndikojnë në zhvillimin e tyre.

Rezultatet: Kërkimi sistematik i kryer në bazat e të dhënave PubMed, Cinahl dhe Embase, duke përdorur fjalët kyçe “kompetencat infermiere”, “e ardhmja”, “sistemet e kujdesit shëndetësor” dhe “ndryshimi demografik”, identifikoi gjithsej 452 artikuj të botuar brenda 5 viteve të fundit. Pas aplikimit të kriterëve të përzgjedhjes dhe vlerësimit të cilësisë metodologjike, në analizën përfundimtare u përfshinë 27 studime. Gjetjet e rishikimit të literaturës kanë nxjerrë në pah disa aspekte kyçe në lidhje me kompetencat e ardhshme të infermierisë dhe fenomenet sociokulturore që do të ndikojnë në to. Së pari, doli se fenomene të tilla si qëndrueshmëria mjedisore, teknologjia, inovacioni, globalizimi, urbanizimi, politikat e pasigurta dhe evolucioni demografik do të kenë një ndikim të rëndësishëm në zhvillimin e kompetencave të infermierisë (Leyva-Moral 2023).

Për sa i përket projeksioneve për ofertën dhe kërkesën e infermierëve, vlerësimet tregojnë se afërsisht 10% e infermierëve që punojnë sot janë të punësuar në fusha të destinuara për t’u rritur, si kujdesi shtëpiak, shërbimet e telemjekësisë dhe ambientet e kujdesit për të moshuarit, ndërkohë që do të ketë një ulje të rreth 20% në ofertën e infermierëve për shkak të faktorëve të tillë si pensioni i brezit të rritjes së fëmijës dhe mungesa e atraktivitetit të profesionit për brezat e rinj (Smiley et al., 2023; ). Kjo nënkupton që pjesa më e madhe e fuqisë punëtore të infermierisë, pothuajse 70%, do të operojë në zona të karakterizuara nga një shkallë e lartë pasigurie dhe paparashikueshmërie, si kujdesi parësor, shërbimet e urgjencës dhe repartet e specializuara spitalore (Gifford et al., 2022). Kjo dinamikë nënvizon nevojën për të zhvilluar kompetenca që lejojnë infermierët të përshtaten me kontekstet



e punës në zhvillim të shpejtë dhe vazhdimisht në ndryshim, të tilla si aftësia për të trajtuar situatat e krizës, për të menaxhuar rritjen e kompleksitetit të kujdesit dhe për të bashkëpunuar në mënyrë efektive në ekipet multidisiplinare. Një aspekt veçanërisht i rëndësishëm i theksuar nga rishikimi është theksi mbi zhvillimin e kompetencave ndërpersonale, të nivelit më të lartë njohës dhe të sistemit. Aftësi të tilla si zgjidhja e problemeve, marrja e vendimeve, analiza dhe vlerësimi i sistemit, dhe kompetencat që lidhen me një vizion sistemik do të jenë veçanërisht të kërkuara (Li et al., 2023). Këto gjetje nënvizojnë nevojën që infermierët të fitojnë kompetenca që shkojnë përtej aftësive tradicionale teknike dhe të lidhura me kujdesin, në mënyrë që të jenë në gjendje të adresojnë probleme komplekse, të marrin vendime të informuara, të kuptojnë sistemet e kujdesit shëndetësor në tërësi dhe të promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Rezultati total është llogaritur nga një maksimum prej 243 (27 studime x 9 kritere), dhe përqindja që përfaqëson rezultatin e përgjithshëm të cilësisë.

Rezultati i përgjithshëm i cilësisë prej 67.1% sugjeron një nivel mjaft të mirë të cilësisë metodologjike në studimet e përfshira në rishikim. Pikat e forta shihen në kampionimin përfaqësues, matjet e vlefshme dhe të besueshme të rezultateve, analizat e duhura statistikore dhe interpretimi i qëndrueshëm i rezultateve. Fushat me rezultate relativisht më të ulëta janë përdorimi i modeleve të përshtatshme sasimore dhe cilësore të studimit, si dhe identifikimi dhe adresimi i faktorëve ngatërues. Këto paraqesin mundësi për përmirësim në kërkimet e ardhshme mbi këtë temë.

Konkluzione: Rishikimi aktual i literaturës ka ofruar një analizë gjithëpërfshirëse të kompetencave të ardhshme të infermierisë dhe fenomeneve kryesore sociokulturore që do të formësojnë zhvillimin e tyre. Gjetjet nënvizojnë rëndësinë e adoptimit të një qasjeje holistike dhe strategjike për të adresuar sfidat dhe mundësitë me të cilat përballet profesioni i infermierisë në vitet në vijim.

Rishikimi ka theksuar nevojën që infermierët të fitojnë një grup kompetencash të larmishme dhe fleksibël, duke shkuar përtej af-

tësive tradicionale teknike dhe të lidhura me kujdesin. Në mënyrë të veçantë, theksi mbi zhvillimin e kompetencave ndërpersonale, të nivelit më të lartë njohës dhe të nivelit të sistemit pasqyrojnë kompleksitetin në rritje të kon- teksteve të kujdesit shëndetësor dhe nevojën që infermierët të kenë një kuptim sistematik të peizazhit në zhvillim të kujdesit shëndetësor. Studime të tilla si ato të Dhuper et al. (2022) dhe Emsley et al. (2022) ilustrojnë rëndësinë e këtyre kompetencave në menaxhimin e programeve të kujdesit dhe mbështetjes të informuar për traumën. Për më tepër, rishikimi ka identifikuar rëndësinë në rritje të kompetencave plotësuese, të tilla si shërbimet personale dhe të klientëve, aftësitë vendimmarrëse, aftësitë teknologjike, kreativiteti dhe metoda shkencore. Hulumtimi nga DeGrande et al. (2022) dhe Gresham et al. (2020) nënvizon rolin kritik të këtyre kompetencave "të buta" në sigurimin e kujdesit infermieror me cilësi të lartë, me në qendër pacientin në të ardhmen.

Për të mbështetur zhvillimin e këtyre kompetencave infermierore të orientuara drejt së ardhme, gjetjet nënvizojnë domosdoshmërinë e një zhvendosjeje kulturore brenda profesionit, shoqëruar me politika dhe inves-

time të synuara në trajnime dhe zhvillim të vazhdueshëm profesional. Sistemet e arsimit dhe trajnimit do të duhet gjithashtu të përshtaten, duke shkuar përtej modeleve lineare për t'u fokusuar në kultivimin e kompetencave "struktorore" dhe kapaciteteve të të mësuarit gjatë gjithë jetës. Kjo qasje mbështetet nga studime të tilla si ato nga Greeff et al. (2020) dhe Weber et al. (2022), të cilat theksojnë nevojën për elasticitet dhe përshtatshmëri në edukimin infermieror.

Si përfundim, rishikimi aktual thekson rëndësinë kritike të trajtimit në mënyrë proaktive të kërkesave në zhvillim të kompetencës të profesionit të infermierit. Duke adoptuar një perspektivë afatgjatë, holistike dhe duke zbatuar iniciativa strategjike, komuniteti i infermierëve mund të sigurojë që profesioni të jetë i pajisur për të përmbushur nevojat komplekse të kujdesit shëndetësor të së ardhmes dhe të vazhdojë të ofrojë kujdes të jashtëzakonshëm për pacientët dhe komunitetet në mbarë botën. Hulumtimi nga Alenazi et al. (2021), Arrogante et al. (2021), dhe të tjerët nënvizojnë rëndësinë e trajnimit dhe përshtatjes së vazhdueshme në zhvillimin e këtyre kompetencave.





# KUJDESI INFERMIEROR SI DHE MENAXHIMI I DHIMBJEVE TEK PLAGËT POST-OPERATIVE

*Leonora Kryeziu, Syzana Nuhiu, Teutë Mahmuti*


Dhimbja postoperative është një fenomen kompleks që përfshinë faktorët fizik, psikologjik, social, kulturor dhe mjedisorë të cilat ndërlihen dhe ndikojnë në atë se si dhimbja perceptohet, menaxhohet dhe vlerësohet (International Association for the Study of Pain, 2003). Dhimbja është një eksperiencë personale për pacientët dhe profesionistët shëndetësorë dhe është e ndikuar nga konteksti në të cilin ndodhë. Në kontekst inkuadrohen aspekte të shumta dhe përfshijnë atë se si komunikojnë profesionistët shëndetësorë me njëri tjetrin dhe me pacientin për të përcaktuar strategjinë që duhet implementuar në menaxhimin të dhimbjes. Dhimbja akute është një problem i rëndësishëm në gjendjen postoperative. Pacientët raportojnë informata të pakta rreth matjes së dhimbjes dhe kontrollin e paefektshëm të dhimbjes. Infermierët vazhdojnë të mbështeten në masat farmakologjike dhe kanë tendencë për të nën-administruar analgjetikët. Qëllimi i këtij studimi është përcaktimi i strategjive të cilat infermierët i përdorin për të menaxhuar dhimbjen

postoperative tek pacientët. Pikë fillestare e kësaj teze ishte interesimi për të ditur se sa pacientët pas operacionit janë të trajtuar për të ulur ose liruar vuajtjet e tyre nga dhimbja, çfarë mund të bëjnë infermierët për të ndihmuar në përkujdesje të këta pacientë, dhe çfarë mund të bëhet për të përmirësuar kujdesin infermieror ndaj pacientëve postoperativ.

Dhimbja dhe kocepti i dhimbjes - Dhimbja është shpesh e përshkruar në literatur si një ankesë subjektive e cila vepron si një shenjë paralajmëruese (Rockville, 2000; Hartric, 2004). Në vitin 1968, Mc Caffery definoi dhimbjen si "çdo gjë që personi përjeton thotë se është, ekziston kurdo që ai/ajo thot që ka ndodhur" (Mc Caffery & Pasero, 2002). Ky

definim thekson se dhimbja është një eksperiencë subjektive. Gjithashtu thekson se pacienti, jo ofruesi i kujdesit shëndetësor, ka autoritetin mbi dhimbjen dhe vetraportimi i tij apo saj është një nga treguesit më të besueshëm të dhimbjes. Dhimbja postoperative është një lloj i dhimbjes akute. Shoqata amerikane e anesteziologjistëve (ASA) definoi dhimbjen në gjendjen post-operative si dhimbje që është e pranishme tek një pacient kirurgjik për shkak të një procedure paraekzistuese kirurgjike, ose një kombinim i burimeve në lidhje me sëmundjen dhe procedurat (American Pain Society, 1995).

Vlerësimi i dhimbjes post-operative: Shkallëzimet e dhimbjes janë të dokumentuara me shkrim, duke i bërë





ato lehtësisht të disponueshme për të gjithë profesionistët e kujdesit shëndetësorë. Ka shumë mjete të sugjeruara për vlerësim që janë gjetur në literaturë dhe shumë shkallëzues janë zhvilluar për t'iu ndihmuar infermierëve në përcaktimin e peshës së dhimbjes. Përdorimi i shkallëzuesve të standardizuar ka shumë avantazhe. Së pari, janë të besueshëm, objektivë dhe kështu në mënyrë të saktë shkallëzojnë nivelin e dhimbjes. Së dyti, marrin pakë kohë për implementim. Së treti, i njëjti shkallëzues mund të përdoret për të vlerësuar efektivitetin e ndërhyrjeve.

#### **Qëllimi i punimit:**

Ky punim si qëllim primar ka pasur që të bëhet vlerësimi i njohurive infermiore lidhur me rolin e tyre në menaxhimin e dhimbjes tek pacientët postoperativ.

#### **Metodologjia:**

Metoda e hulumtimit ishte kuantitative, është bërë analizimin statistikor i të dhënave nga vlerësimet, opinionet dhe qëndrimet e pjesëmarrësve dhe në gjenerimin e tyre në vlera numerike të ofruara nga pyetësorët. Pjesëmarrësit në këtë hulumtim ishin të dy gjinive, dhe të moshave të ndryshme.

Metoda e mbledhjes së të dhënave:

Është përpiluar pyetësori anonim me pyetje të mbyllura dhe të hapura me dy e më shumë zgjidhje dhe është marre pëlqimi i tyre për plotësimin e pyetësorëve. Pyetësori është i përbërë nga katër pjesë: pjesa e parë: moshë, gjinia, përvoja e punës, niveli i edukimit, pjesa e dytë: njohuritë e fituara për menaxhimin e dhimbjes postoperative dhe identifikimi i programeve edukuese të nevojshme, pjesa e tretë: vlerësimi, trajtimi dhe dokumentimi i dhimbjes postoperative, si dhe pjesa e katërt: barrierat në menaxhimin e dhimbjes postoperative.

Metoda e analizimit të të dhënave:

Analizimi i të dhënave është realizuar me ndihmën e programit për

kalkulime tabelare (Microsoft Office Excel). Fillimisht të dhënat janë analizuar në tërësi e pastaj të selektuara sipas moshës, gjinisë, përvojës së punës, nivelit të edukimit dhe duke tentuar të gjenden krahasime të opinionëve varësisht nga specifikat e lartëshënuara të mostrave, pyetjet e hapura u analizuan po ashtu duke i shqyrtuar dhe seleksionuar komentet e secilit pjesëmarrës. Procesi i analizimit të të dhënave është paraqitur me përqindje (%) dhe frekuencë (f) të ilustruara në tabela dhe grafikone.

#### **Rezultatet:**

Në pyetjen se a e bëni dokumentimin e dhimbjes përmes të dhënave objektive (p.sh. përshkrimi i dhimbjes, vlerësimi me shkallëzues me numra ose fytyrë etj)? Përgjigjet e pjesëmarrësve ishin se: 79% e të anketuarve janë përgjigjur "JO" në këtë pyetje, 21% "PO". Pra, dokumentimi i dhimbjes si dhe vlerësimi i shkallës së dhimbjes përmes të dhënave objektive nuk bëhet saktë dhe në mënyren



e duhur në institucione shëndetësore. Në pyetjen tjetër: Nga eksperiencia juaj çfarë është përqindja që pacientët aktual post-operativë arrijnë të lirohen kënaqshëm nga dhimbja?, ata janë përgjigjur me sa vijon: nga të gjithë pacientët diku 76-85% e tyre arrijë që të jenë të liruar kënaqshëm nga dhimbja, ndërsa 13-23% prej tyre kanë deklaruar se nuk kanë qenë kënaqshëm të liruar nga dhimbja si dhe 2% të cilët pavarësisht aplikimit të teapisë dhe aktiviteteve tjera atyre nuk kishin arritur për të u ndalur dhimbjet post-operative. Pyetja tjetër ishte ajo se tek pacienti për mos sukses për ndalje të dhimbjeve postoperative sa

kanë ndikim: Efektet e barnave tek pacientët e ndryshëm, përshkrimi i dozës së terapisë si dhe administrimi i dozës së terapisë. Nga rezultatet e grumbulluara mund të konkudojme se efektete e barnave tek pacientët e ndryshëm kishin një përqindje prej 21%, përshkrimi i dozës së terapisë 23.5% si dhe administrimi i terapisë me një përqindje prej 55.5%. Pyetja tjetër: cili është veprimi më efikas në menaxhimin e dhimbjes postoperative?, ata janë përgjigjur: dhënia me kohë dhe e duhur e terapisë dhe analgjetikëve me 61,5 %, pozita më e përshtatshme ku pacienti ndihet rehat 19 %, mirëmbajtja dhe kontrollimi i plagës 12.5 %, komunikimi verbal dhe joverbal me klientin 5.5 % si dhe 1.5 % të cilët nuk janë deklaruar fare.

#### **Diskutimet:**

Duke u bazuar në analizimin e rezultateve të nxjerra nga përgjigjet e respondentëve të përfshirë në këtë hulumtim kemi arritur deri te këto përfundime:

- Thuajse të gjithë pacientët post-operativ lirohen kënaqshëm nga dhimbja.
- Administrimi i dozës jo adekuate të analgjetikut është paraqitur si problemi më i zakonshëm në menaxhimin e dhimbjes.
- Infermierët që merren me menaxhimin e dhimbjes post-operative përdorin metoda të ndryshme për t'iu ndihmuar pacientëve që të ndihen ata sa më komod dhe pa dhimbje nga problemet e tyre.
- Infermierët përpos barnave dhe aplikimit të terapisë përdorin edhe mënyra tjera për të menaxhuar dhimbjen e pacientëve si: komunikimin, pozitën e përshtatshme, kujdesin ndaj plagës etj.
- Stafi punues - infermierët në njësi dhe reparte ndjehet plotësisht të përgatitur profesionalisht për t'u përballur me probleme të ndryshme në menaxhimin e dhimbjes post-operative.



# KUJDESI INFERMIERORË TEK PACIENTËT ME ANEMI NË SPITALIN E FERIZAJIT

Hulumtimi është realizuar gjatë periudhës kohore 2019-2021 dhe qëllimi i tij ishte që të identifikoj se cila gjini dhe grupmoshë është e prekur me shumë nga anemia

## Donjeta Krasniqi

Hyrje: Anemia ndikon në zvogëlimin e masës së eritrociteve në gjak, e cila përcillet me zvogëlimin e koncentrimin të hemoglobinës, të shprehur në një litër gjak. Anemia shprehet edhe me zvogëlimin e hematokriteve në gjak. Anemia shfaqet te të gjitha moshat, gjinitë etj. Anemia përkufizohet si një gjendje e manifestuar me një numër të reduktuar eritrocitet dhe hemoglobines në gjak. Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë, kufiri vlera e hemoglobinës për meshkujt mbi 14 vjeç është Hb<130 g/L dhe për femrat Hb<120 g/L.

Përqendrimi i hemoglobinës (Hb) është faktori më i besueshëm për diagnozën e anemisë. Prioritetet e infermierisë për pacientët me anemi përfshijnë adresimin e oksigjenimit të pamjaftueshëm, menaxhimin e lodhjes dhe intolerancës ndaj aktivitetit, identifikimin e mangësive ushqyese, administrimin e medikamenteve të përshkruara, monitorimin e transfuzioneve të gjakut, ofrimin e edukimit dhe mbështetjes dhe bashkëpunimin me ekipin e kujdesit shëndetësor për kujdes të plotë.

Qëllimi i punimit: Qëllimi parësor i këtij hulumtimi është që të konstatohet se është bazuar në atë se cila gjini dhe grupmoshë është më e prekur nga anemia në rajonin e Ferizajit për periudhen tri vjeçare.

Kujdesi infermieror: Pavarësisht nga shkaktarët e shumtë që e kanë shkaktuar anemin, efektet e anemisë tek pacientët dhe kujdesi infermieror janë të ngjajshëm për të gjithë tipat e anemisë. Çdo pacientë i cili ka anemi kërkon një vlerësim të detajuar për ti ditur shkaktarët që shkaktojnë anemi. Menaxhimi i kësaj sëmundje bazohet dhe fokusohet në parandalimin dhe trajtimin e anemisë. Pacientët duhet edukuar në shmangjen e disa aktiviteteve, ti njohin shenjat dhe simptomat e herëshme në mënyrë që ti shmangin pasojat e mëdha dhe të fillojnë në trajtimin sa më të hershëm të anemisë. Menaxhimi i anemisë nga infermierët duhet të jetë i saktë dhe i përshtatshëm në mënyrë që të arrihen objektivat dhe qëllimet për kujdes të plotë.


Një infermiere e kualifikuar mbledh të dhëna për krijimin e një plani të kujdesit shëndetësor. Mbledh një histori të detajuar mjekësore dhe, pas ekzaminimit të pacientit, harton prioritetet për planin e kujdesit shëndetësor. Infermierja do të bashkëpunojë me pacientin, anëtarët e tjerë të ekipit dhe me familjen e pacientit për zbatimin e kujdesit shëndetësor në kuadër të kompetencave të tyre. Infermierja do të drejtojë procedurat e planifikuara sipas procedurave standarde të pranuar dhe do të dokumentojë ato procedurat e zbatuara.

Metodologjia: Në këtë studim është përdorur metoda retrospektive, kurse mledhja e të dhënave është bërë në Spitalin Rajonal të Ferizajit në repartin e hematologjisë. Mostër ishin të gjithë pacientët e shtrirë gjatë kësaj kohe të cilët janë trajtuar nga anemia në këtë spital. Të gjitha rezultatet e nxjerrura nga protokolet e pacientëve janë paraqitur në tabela dhe grafikone

| Gjinia   | Nr. | Përqindja % |
|----------|-----|-------------|
| Meshkuj  | 46  | 40.7%       |
| Femra    | 67  | 59.3%       |
| Gjithsej | 113 | 100%        |

duke përdorur programin Excel.

Hulumtimi, grumbullimi dhe nxjerrjen e rezultateve



për Periudhen (Janar 2019- dhejtor 2021), është bërë në Spitalin regional të Ferizajit – në repartin e hematologjisë ku gjithësejt gjatë kësaj periudhe janë mjekuar 113 pacientë.

Në grafik shihet, se gjinia më e prekur me anemi janë femrat me 59.3% ndërsa meshkujt 40.7% .

**Rezultatet:** Gjetjet tregojnë se më të prekur janë kryesisht gjinia femrore në një përqindje pak më të lartë se gjinia mashkullore. Në studim kemi përfshirë: Periudhen (2019-2021), që e kemi bërë në Spitalin regional të Ferizajit, ku kemi 113 raste

gjithësejt të cilat i kam sistemuar dhe klasifikuar në tri periudha ku gjithësejt kemi 67 raste femra apo 59.3% dhe 46 raste meshkuj apo 40.7%.

Për nga grupmoshat kemi kë rrë to të dhëna të përgjithshme: 18 deri 29 vjet kemi 17 apo 15.0%; nga 30 deri 40 vjet gjithësejt kemi 9 apo 7.96%; nga 41 deri 50 vjet kemi 16 apo 14.2%; nga moshë 51 deri 60 kemi 29 raste apo 25.7%; gjithashtu te grupmosha 61 deri 70 në total kemi 29 raste apo 25.7% dhe te grupmosha mbi 70 vjet kemi gjithësejt 13 raste apo 11.5%. Sa i përket vendbanimit në total nga zona urbane apo qyteti kemi 58 raste apo 51.3%, e nga zona rurale apo fshatrat kemi 55 raste apo 48.8%.

Diskutimi: Anemia mund të jetë një sëmundje shumë e lodhshme dhe nëse nuk trajtohet në kohë mund të rrezikohet shëndeti i personit të diagnostifikuar me anemi. Trajtimi përcaktohet nga shkaku dhe arsyeja dhe origjinën e sëmundjes. Është shumë e rëndësishme të zbulohet shkaku i vërtetë i anemisë në mënyrë që ajo të trajtohet siç duhet për të shëruar. Kjo mund të bëhet vetëm me ndihmën profesionale të një mjeku që do të përcaktojë strategjinë e trajtimit. Pacientët anemikë mund të jenë shumë të dekurajuar sepse sëmundja ndikon në kryerjen e aktiviteteve të ndryshme. Gjetjet tregojnë se më të prekur janë kryesisht gjinia femrore në një përqindje pak më të lartë se gjinia mashkullore e këtu sikur isht ka të bëjë me stilin e jetës, ushqimi, procesi i të lindshmërisë dhe faktorëve gjenetik. Këto të dhëna përpunohen me literaturë të hulumtuar nga autorë të huaj.

Shembull kemi marrë edhe të dhëna nga autor të ndryshëm. Si dhe sipas një studimi tjetër të bërë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, kryesisht të universitetit të Floridas nga James F.Collins nëntor 2016 (Collins, 2016). Rezultojmë se: Ndër të gjitha grupmoshat, fëmijët e moshës shkollore (5-11 vjeç) kishin prevalencën më të ulët të anemisë (2,0%). Për më tepër, anemia e moderuar-e rëndë ishte më pak e zakonshme tek fëmijët e moshës parashkollore (0,5-4 vjeç, 0,5%) dhe fëmijët e moshës shkollore (5-11 vjeç, 0,5%). Grupmosha 80-85 vjeç kishte përqindjen më të lartë të anemisë (19,4%) Normat e anemisë tek burrat u rritën me moshën, ndërsa ajo e grave u rrit dyfish në grupmoshën 40-49 vjeç dhe 80- 85 vjeç.



## FOTOGALERI







**Oda e Infermierëve, Mamive dhe  
Profesionistëve tjerë Shëndetësor**